



Idriz Ponari

KUR KOLOVITESHIN TROFTAT NEN PISHTARE

tregime

891.983-32

5

P. 85

IDRIZ PONARI

KUR KOLOVITESHIN TROFTAT NËN PISHTARË...

Tregime dhe novela

~~56762~~ 3021



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

«PO E ÇOJ KANGËN TE SHPIA»

Në orën gjashtë nisej maqina. Stacionin s'e kisha larg. Ishte dita e parë. Tre burra po prisnin. Njëri prej tyre, një burrë rrëth të dyzetave, veshur me kostum doku gri po fliste në këmbë:

— Erdha t'ju njoftoj që të mos më prisni kot. Më është prishur maqina. E futa të ma rregullonin jashtë radhe. Bëhet ajo rrugë, kur maqina është me difekt? Jam lodhur shumë sot, por ama gazetën e nisa që në orën pesë...

Fshatarët heshtnin. «Ja dhe dita e parë, mendova unë. Duhet të nisem në këmbë. Rrugën nuk e di. Larg është.»

— Ju mos u largoni. Ndoshta vjen ndonjë maqinë — tha shoferi dhe u zhduk duke buzëqeshur prapa kthesës.

Unë ndeza një cigare dhe fillova t'i hidhja një sy gazetës. Njëri nga fshatarët u nis në këmbë, ndërsa ai plaku m'u afrua e më pyeti:

— Po ju, maqinë prisni, o djalë?

— Po.

— E ku do shkoni, në malësi?

— Po.

— Me shërbim?

«E dashka hollë ky xhaja», mendova.

— Jam caktuar arësimtar atje, o xhajë.

— Arësimtar? — Plakut i shkëlqyen sytë. Ma zgjati dorën. — Besa mirë — tha plaku. — Si e ke emrin, o djalë?

— Besnik.

— E gëzofsh! — tha plaku. — Besa mirë! Djem të mirë na vijnë...

Ndërkhohë u duk një maqinë.

— Erdhi maqina jonë — tha plaku.

Ne shkuam drejt saj.

Shoferi zgjati kokën në qoshe të spondit e na porositi të mos uleshin mbi mushamanë e zezë, mbasi kishin futur gjëra që thyheshin.

— Ta ndezim një herë? — tha plaku. Ne ishim ulur pranë njëri-tjetrit.

Unë e mora kutinë, sado që e dija se brenda kishte duhan të fortë. Sa dolëm nga qyteti, maqina zuri të ecte me të shpejtë. Fushave dëgjohej kënga e punës e përzier me zhurmë traktorësh e maqinash. Një hambar i madh prodhimesh të bollshshme. Në të dy anët e xhadesë çaheshin ugarë, mblidhnin e transportonin misrin. Era e tokës vinte deri te ne.

Maqina ndaloi papritmas. Unë zgjata kokën mbi kabinë të shihja se mos ishte kontrolli rrugor. Ne nuk kishim bileta. Po, kur pashë një plakë me një djalë, u qetësova.

— Heu, — tha plaku — sa paski ecur bre!

Plaka ju përgjegj:

— Dhe sa do të ecnim se...

Plaka zuri vend në mes të karrocerisë. Ajo mbante në prehër një diçka të futur në një thes bezeje të bardhë borë. Herë pas here shikonte të nipiñ dhe nga fjalët, që i thoshte me zë të ulët, na

dukej sikur e porosiste të mbahej fort pas krahut të saj. Djali ashtu bënte. Por ai kapte atë gjënë e bardhë, që mbante plaka. E shtrëngonin të dy atë gjënë e tyre, sikur do t'u fluturonte nga dora. Plaka s'ja ndante sytë. Ajo dukej sikur bisedonte me atë gjënë e saj (që duhej të ishte e çmuar me siguri). Fytyrën e kishte tërë rrudha, flokët e thinjur e tregonin rreth të gjashtëdhjetave. E shikoja dhe pyesja veten: «Ç'do të ketë vallë plaka në thes?»

Rruga kalonte nëpër një grykë mali me shkëmbinj të thepisur. Vende-vende shkëmbinjtë e dy faqeve të malit gati sa nuk takoheshin. Prej an-dej qielli dukej si një pikturë e grisur, ku zinin vend malet kreshtore të veshura me drunj gjigantë që mbushnin ahishtet, ndërsa lart, në shkëmbin e gjallë, pishat kishin ngulur rrënjet dhe férshëllënin edhe tani në verë kur frynte një fllad i lehtë. Përmes shkëmbinjve kalonte rruga e ngushtë, e pa shkelur, me kthesa të shumta malore, të forta, në të cilat maqina rënkonte e ngjitej me zor.

Plaka gjithë rrugës mbante para duarve gjënë e saj të çmuar. Dukej se u frikësohej tronditjeve... Ajo ishte e përqëndruar vetëm tek ajo peshë që mbante në duar. Plaka mendonte në heshtje.

— Dua të shikoj Brinjën e Caracit — tha djali.
— E kemi larg — tha plaka.

— E ç'do t'i shohësh, o bir, asaj Brinjës së Caracit. Djersa jonë në te asht tha tani — tha plaku.

Djali vetëm qeshi.

— I kam tregue unë djalit sa e sa herë — u përgjegj plaka. — Duhet ta dijë ky jetën tonë. Ja kam tregue qysh në djep kur e përkundsha.

— Eh! — tha plaku.

— Sa njerëz kanë humbë — tha plaka.

— Ja, tek ai shkëmb atje lart, po të frynte ndonjë stuhi, s'kaloje dot në kambë — tha plaku.

— Tash edhe me vdekë s'më bahet vonë, — tha plaka — për besë jo, s'më bahet vonë.

— Mos e thuej atë fjalë. Sot çdo ditë është sa një shekull përpara — ja priti plaku.

— E di. Po unë jam e gjëzueme boll. Kur shoh veten në maqinë duke i buzëqeshë Brinjës së Caracit!.. Eh, ajo gjithë jetën asht tallë me djersën tonë. Apo s'asht kështu, o Rami?

Plaku ishte kredhur në mendime. Pyetja e plakës sikur e zgjoi për një çast. Ai ngriti sytë, por s'u përgjegj. Plaku heshti. Maqina ngjitej me vështirësi. Plaka shtrëngonte fort peshën që mbante në prehër.

— Në spital ishe? — pyeti plaku.

— Mos e thuej atë fjalë. Deri më sot nuk më dhemb kërkund, vetëm se gjuri im nuk asht ma për rrugë të gjata...

— S'mendova se mund të zbritshe prej malësie për punë tjetër — tha plaku.

— Jam e fortë, o Rami — tha plaka.

— Po aty ç'ke mbështjellë?

Ajo na shikoi me buzë në gaz e foli:

— Radion. Në qytet për këtë shkova.

— E bleve? Me hajr!

— Jo, more. Radion e bleu djali dy javë para se të vijshin dritat... — Qeshi kur tha këto fjalë, qeshi me vete, pastaj na tha: — E dini pse po qesh? M'u kujtua kur e bleu radion djali... Mori një top me pare. I shikova. Shumë m'u dukën për besë... Djali ma kuptoi mendjen mue e më tha: «Kur ta

sjell radion, ti do të më japësh edhe një herë kaq e s'do më lesh ta heq nga shtëpia.» Unë s'bëzajta. Më në fund dolën fjalët e tim biri... Po na u prish një ditë. E mbeti shtëpia pa kangi. U çova e u nisa vetë për në qytet. Kaq vjet kam që s'e baj këtë rrugë. Po, s'ka gja tashti po e çoj kangi te shpia.

— Të vinte djali më mirë do ishte.

— Asht i zanë me ate, si po ja thonë bre...

— Fushatën, gjyshe, — plotësoi nipi.

— He të lumtë goja! — tha gjyshja. — Ash-tu pra, i thashë nipit të më printe përpara dhe dje u nisëm e dje sosëm në qytet.

— Dje?

— Po, po, dje.

— Qenke e fortë, gjyshe — thashë unë.

— Forca ime vëloj prej kësaj që kam në prehën. A e beson se bash prej kësaj. Se prej kësaj radje unë kam ndigjue Enver Hoxhën të flasë në shtëpinë time, në votrën time... Na u duk se Enveri qe ulë aty në ballë të votrës e po ku-ndonte me ne.

Një buzëqeshje përshkonte fytyrën e gjyshes dhe të nipit.

— Kur vjen nipi nga shkolla, i them: «Kallë-zoi gjyshes se çfarë ka radioja sonte?» Ai merr gazeten dhe thërret i gjëzuem: «Flet për ne sonte, për kooperativën tonë, për cuçat tona, për të gjithë do të flasë.» E unë pres të vijë ora e të dëgjoj kur të flasin Mara, Fatimja, Xhemali, Pali...

— Edhe Mira, gjyshe — i tha djali.

— Po, po, edhe Mira. Po kur thanë se rinia po çante shkëmbin e Brinjës së Caracit e do të hapte rrugën e maqinës fill mbrapa, ja morën këngës cu-cat tona, Mira me shoqe. Po ç'kangë që banin ato

cucat tona, që i pastë gjyshja! M'u mbushën sytë me lot. Sa kam urue atë natë unë!...

— Po shpejt ta paskan rregullue — thashë unë.

— Shpejt? — tha ajo. — Jo, mor djalë! — Hiç shpejt s'na e ka ba. Repartin ku ndreqeshin radiot e gjetëm lehtë. Po prisnim të dilte ustai të na shikonte radion. Kur doli një cucë. E bukur boll ishte.

— Urdhëroni — më tha.

Unë shikova radion e fola si me përtesë.

— Ustain që rregullon radiot deshëm.

Ajo cuca e bukur qeshi lehtë e ma mori radion nga dora. E hapi shpejt dhe e pa.

— Më 27 të vish ta marrësh — më tha.

Unë lëviza nga vendi dhe fola me ngut:

— Si bre njëzet e shtatë ditë pa kangë shtëpia jonë. Lum nana qe ku i kam paret me vete. Nana e do radion ta marrë që sot. Jemi larg, nga malësia.

— Jo njëzet e shtatë ditë, moj nënë, — më tha — po tri ditë, sot jemi më 25. Edhe paratë do t'i paguash kur ta marrësh të ndrecurr radion.

M'u duk sikur më ra në kokë me ndonjë gja kur më tha ato fjalë.

— Lum nana, jena mësue me radio, — i thashë — shtëpia jonë duket si e fjetun pa kangë. Thuej ustait të ma rregullojë sot. Më presin fëmija t'ua çoj kangën, t'ua çoj unë gjyshja radion te shpia. Kam kaq vjet që s'e baj këtë rrugë... për këtë erdna. Djali im asht i zanë me ate...

— Fushatën, gjyshe, — plotësoi djali.

— Hë pra, lum gjyshja.

— Po më duken shumë edhe tri orë e jo ma tri ditë.

Si tha këto fjalë, cuca më pa, buzëqeshi, ma

rregulloi radion me duartë e saj. Kur më përçolli, i thashë:

— Sikur të vish në malësi, kanë me të dashë cuçat tonë. Unë do t'u tregoj për ty...

— E pra shpejt ta ka rregullue — thashë unë.

— Për mue s'asht shpejt, o çun — u përgjegj plaka.

— Ruhuni nga shkëmbi — lajmëroi shoferi.

Maqina mori kthesën ngadalë dhe u fut në shkëmbin e çarë ku të rrezikonin gurët. Poshtë, nën shkëmb, qetë-qetë ridhte lumi ujë pak e kaltërosh. Një rrymë e fortë ajri mblidhej atje në grykën e ngushtë midis dy maleve. Pastaj fillonte një luginë e gjerë me ara të veçuara e livadhe të bukura faqeve të malit. Një mjegull e bardhë dhe e hollë endej majë maleve e zbriste deri poshtë në luginë ku fillonte ai gjelbërimi i zverdhur vjeshtak.

Maqina qëndroi përpara shkollës. Ishte një ndërtesë trekateshë ku dallova një sallë të madhe me dritare nga lindja e dyer prej xhami.

Plaka me të nipin zbritën me të shpejtë. Ata po ecnin me ngut duke biseduar. Në dorë mbante të shtrënguar fort radion e saj të mbështjellë në atë thesin e bardhë.

Në veshë më kumbonin fjalët e plakës: «Po e çoj kangën te shpia.»

Dicëka të madhe ndjeva në zemër.

UNE JAM RRITUR, SHOKU KOMANDANT

Ajo qe një mbrëmje e kaltër me yje dhe mëdrita... Po udhëtonim me shofer Lazen. Rruga ishte e vështirë, por ne as që e ndjemë lodhjen. Lazja na qëlloi njeri i muhabetit. Ne morëm vesh se ai ishte jetimi. Lufta ja kishte vrarë njerëzit. Por Lazja gjithnjë thoshte: «Nënë m'u bë Partia. Ajo më rriti, ajo më bëri punëtor» përfundonte ai. Lazja ishte i qeshur, i shkathët... Ne menjëherë mësuam se çfarë i pëlqente atij, çfarë donte ai.

— Pa merrja këngës një herë, o Laze.

— Të këndojmë?

— Të këndojmë...

Dhe kënga s'pushonte, ndërsa rruga mbetej prapa pa u kuptuar.

Në të hyrë të qytetit, atje ku kryqëzoheshin rrugët, Lazja më shikoi dhe unë i thashë:

— Në repart.

Maqina mori kthesën dhe, si kaloi postbllokun, vazhdoi nëpër atë sheshin e gjerë të rrrethuar me ndërtesa shumëkatëshe, që shkëlqenin nga dritat. Plepat si kurorë e gjelbër u zbuluronin gjokset. Shofer Lazja fiku dy-tri herë dritat. Ushtarët u larguan nga rruga. «Të jetë ora e kohës së lirë tani»? pyeta veten.

Një fllad i ëmbël na u përplas në fytyrë e bashkë me të dëgjuam atë melodinë aq të njojur të këngës.

«Ecim, ecim, ecim dhe marshojmë...»

Këndonte një togë e rrjeshtuar. Mbase shkonte në stërvitje natën...

U drejtova andej nga klubi. Në sallë dukeshin ushtarët që këndonin. Më duhej të takoja një shok.

Duke kaluar përmes ushtarëve, po bëhesha gati të pyesja ndonjërin për shokun që kërkoja, kur një ushtar u turr me vrap drejt mëje e m'u hodh në qafë, më pushtoi. Më përqafoi disa herë duke ma mbajtur dorën të shtrënguar. «Duhet të jetë ndonjë nga të afërmit e mi», mendova. Kush i njeh tani! Ata çunakët e vegjël janë bërë burra. Pastaj e shikova më vërejtje. Ai më mbante akoma duart të shtrënguara në të tijat e buzëqeshte... Rreth nesh filluan të afrohen ushtarë të tjerë. «Të jetë ndonjë nga ish ushtarët e mi?» mendova. Ata sytë e tij tërë shkëlqim se ku i kisha parë. Për këtë isha i sigurtë. Dhe solla ndër mend ushtarët e larguar nga reparti...

Jo, ai ushtar mua nuk po më kujtohej edhe pse isha i bindur se diku e kisha parë.

Ushtari, duke m'i shtrënguar duart gjithnjë buzagaz, më pyeti:

— Nuk po më njihni, shoku komendant?

— E ç'ti thosha? C'përgjegje mund t'i jepja unë atij?

Ushtarit i shkëlqenin sytë.

— Jam Zijai, shoku komendant, Zija Bardhi — dhe qeshi me gëzim e lot në sy...

Mua sikur m'u zhduk nga sytë ky ushtar **Zijai** • në vend të tij më rrinte gjithnjë buzagaz një dja-

losh me trup të shkurtër e të hajshëm, me fytyrë të hequr... Ai djaloshi veshur me kostum doku blu... Ai djaloshi... Zijai rekrut, që sapo kishte lënë Myzeqenë e tij të dashur dhe kishte ardhur të merrte në dorë pushkën.

Desha t'i thosha: «Më fal, Zija, nuk të njoha», por atë çast isha unë që e përqafova fort atë ushtarin tim, Zijain.

— Komandanti im — prezantoi Zijai.

U përshëndosha dhe me ushtarët e tjerë.

— Ka kaluar co kohë që atëhere, shoku komandant. Nuk më njohën as shokët.

— Pse, o Zija?

— Unë jam rritur, shoku komandant!

Ushtar Zijai kishte të drejtë. Ai vërtet ishte rritur.

— U kam shkruar edhe prindërve, shoku komandant.

— Për çfarë, ushtar Zijaj?

— U thashë se jam rritur, shoku komandant. Edhe ata, po të më shohin, rrezik të mos më njohin. Unë isha i vogël. E di sa jam dredhur në degën ushtarake kur isha rekrut?

— Pse?

— Kisha frikë mos nuk peshoja as 50 kile. Po kur më matën gjatësinë! «Një e pesëdhjetë e shtatë», thanë «Nejse. Për shofer nuk bën.»

Ne qeshëm me të madhe. Po mua m'u kujtua nënnoficer Llazi atë ditë kur po visheshin rekrutët. Kontrolloi të gjitha kompletet dhe më në fund doli gjithë djersë: «Urdhëro, ushtar Zijai, më të vogël

se këtë numër nuk kam në depo, provoje njëherë», kishte thënë Llazi.

Kur u vesh, mua m'u duk më i vogël nga ç'i-shtet civil. Rrobat i rrinin të mëdha. Bustina i rra-sej deri te veshët. Rripit të mesit i duheshin hapur vrima të reja, pastaj mëngët e gjimnastiorkës duheshin kthyer nga brenda dy-tre fish... Tek ecte rëndë-rëndë me ato këpucë, më dukej se mezi i ngrinte. Edhe atij i dukeshin të rënda. Ja, ky ushtar Zijai. Shikojeni tani!

Në repartin tonë ushtar Zijai qëndroi vetëm pak ditë. Një mbrëmje, kur po caktonin ushtarët që do t'i dërgonim për të kryer kursin e ndërlidhjes, ndodhi kështu:

— Për radistë duhet të dërgojmë ushtarë të zgjedhur — u tha në mbledhje. — Ndërlidhja, sistemi nervor i ushtrisë...

— Edhe unë i një mendjeje jam, — tha një tjetër — bile dua të theksoj se radisti duhet të ketë edhe trupin të shëndoshë, edhe shkollën të plotë (ishte fjala për të nesërmen), duhet të ketë edhe... edhe...

— Sa për ushtar Zija Bardhin, unë mendoj — tha një i tretë — se nuk bën për radist. Shokët parafolës e cilësuan mirë atë që duhet të ketë një ushtar i zgjedhur, një ushtar radist...

Në sallë sundoi heshtja. Pritej të diskutohej për ndonjë ushtar tjetër. U ngrit komisari. Foli shkurt:

— Ju, shokë, nuk duhet të harroni se ne çdo vit presim me dashuri në repartin tonë ata djelmosha të rinj që vijnë nga skajet më të largëta të Athdheut, ata që as ne s'jemi në gjendje të përcaktoj-

më se sa shpejt rriten, më shpejt se filizat në pranverë, më shpejt se fieri i bjeshkëve... Zijai është i fortë.

Të nesërmën ushtar Zijai u largua nga reparti ynë... Që atëherë s'e kisha takuar fare. Ai më pyeste tani për Yllin, për Palin, për Sotirin, për poligonin e ri që e kishim elektrifikuar. Zijai deshte të dinte gjithshka për repartin e tij.

— Po ju? — e pyeta unë. — Si ja çoni?

— Tani jemi në përfundim të kursit — ja priti një nga ushtarët.

— Dhe do të kthehem përsëri në repart — tha Zijai.

— Besoj se jeni prenatitur mirë — i thashë unë.

— Mirë — tha Zijai.

Po unë e dija që Zijai shkonte shumë mirë dhe ishte më i dalluari. Po ai s'e bëri veten.

— Megjithatë duhet të punojmë më shumë — tha një ushtar.

— Tani ne kemi garat — ja priti një tjetër.—
Të shohim si do dalim.

— Çfarë garash keni? — i pyeta unë.

— Garat e të rinjve.

— Të gjithë do të merrni pjesë?

— Të gjithë.

— Në fund do të ketë gara midis të dalluarve.

Zijait i shkëlqenin sytë. Ai e ndjen ethen e provimeve të fundit. Po, tani Zijai ishte rritur shumë. Atë s'e dalloje dot midis shokëve, ishte bërë një me ata. Dhe më dukej sikur ende dëgjoja zërin e ushtar Zijait duke më thonë plot dashuri: «Unë jam rritur, shoku komandant... Më shikon, jam bërë radist i mirë... Unë, ushtari trupvogël...»

Një fllad i lehtë frynte duke i bërë të fëshfë-rinin gjethet e plepave atje pranë.

Ne u ndamë. Ishte ora e fjetjes.

Dhe unë, duke kaluar rrugëve që shkëlqenin nga neonet, mendoja për ata ushtarë e midis tyre sikur dëgjoja akoma një zë të gëzuar, zërin e ushtarit.

H O L T A

Atë pasdreke Gëzimi u vonua. Unë, si bisedova në telefon me drejtorinë, u nisa për në hotel duke shpresuar se do ta gjeja atje. Po, kur gjeta cëlësin në sportel, çdo gjë u sqarua. Gëzimi s'kishte ardhur. Por në dhomë nuk më rrihej vetëm. Çdo mbrëmje unë dhe Gëzimi dilnim të shëtisnim. Ne shëtisnim derisa këmbët na këputeshin nga lodhja.


Po ç'të bëja tanë vetëm? Dhe dola.

Duke kaluar në bulevardin kryesor, u ndodha pranë mureve të kalasë së vjetër. Ata gurë të mbuluar nga myshku sikur më tretnin në lashtësinë e viteve. Pak më tej një pllakë e bardhë e vendosur në atë mur të lashtë. Rrugë me kalldrëm dhe shtëpi dykatëshe të ndërtuara me stil oriental e me avlli pérpara. Po andej nuk kishte asnë pllakë «Monument kulture», si në muret e kalasë...

Kështu kaloi edhe ajo mbrëmje. U ktheva në hotel më shpejt se netët e tjera.

*
* *

Ndërtesa pesëkatëshe e turizmit shkëlqenë nga dritat. Nga lulishtja dëgjoheshin tingujt e orkestrës.



Në rrugë përpara hotelit kishin qëndruar vetura të targave të ndryshme

Sporteli qe në katin e parë. Unë u afrova. Nga telefoni dëgjova këtë bisedë:

— Po. Ne jemi.

— Kë kërkoni?

— Në çfarë dhoma?

Mua më shkoi mendja te Gëzimi. Mundet të më kërkonte për ndonjë gjë.

— Dhoma 201! (Ishte dhoma ku flija unë).

— Do presësh një çikë — tha sportelistja, ndërsa unë u afrova e i thashë me ngut:

— Më jepni receptorin. Kush më kërkon?

— Një vajzë...

— Një vajzë?! Alo?.. Sa të gjata m'u dukën ato sekonda, derisa më në fund dëgjova të më përgjegjej abonentti. Një zë i largët femre. Edhe tani çuditem si nuk më bëri përshtypje ai zë aq i ëmbël, ndaj, pa e zgjatur shumë, e pyeta me ton pak si të ashpër:

— Shoqe, kë kërkoni?

— Hotel turizmin.

— Po. Nga hoteli flasim.

— Kërkoj një shok në dhomën 201!

— Unë fle në atë dhomë.

Si i thashë këto fjalë, nuk dëgjova më zërin e saj shoqes në telefon, ndaj, nga frika se mos na ndërprisin, lëshova nga goja radhas ato alo... alo... alo. derisa më në fund dëgjova përsëri zërin e saj:

— Alo. Lili, ti je?

— Jo, sigurisht që s'jam Lili — i thashë.

— Alo, Lili, mos u tall në telefon — dëgjova një zë krejt të ri e të ashpër.

Më në fund u morëm vesh dhe ajo shoqja m'u lut që të shikoja në dhomë se mos ishte Lili i saj. Unë pranova dhe i ngjita shkallët me ngut aq sa, po të mos qenë ato qilimat e rrugicat, do të kisha shkarë e do të kisha thyer ndonjë këmbë në plakat e lëmuara që shkëlqenin. Po dera qe e kyçur dhe vetëm kur kapa dorezën, m'u kujtua se në xhepin tim ishte çelësi i dhomës 201.

— Shoqe, nuk ka njeri në dhomë.

— Ai para dy orësh më kishte marrë në telefon, por edhe unë s'u ndodha afër dhe më kishte lënë adresën.

— Nga flisni ju?

— Nga fshati S.

— E ç'të them...

Më dukej sikur e dëgjoja atë frymëmarrjen dhe heshtjen e saj në telefon, ndaj e pyeta më tepër për të mbyllur bisedën.

— Si quheni?

— Holta.

— Mirë, Holta, unë do t'ja them Lilit.

— Të faleminderit.

— Asgjë. Natën e mirë!

* * *

Po lexoja një libër. Nga lulishtja poshtë dëgjo-heshin qartë tingujt e orkestrës. Dera trokiti dhe në dhomë hyri një djalë trupgjatë me flokë e sy të zez. Në dorë mbante një gazetë, ku kishte mbështjellë diçka. Kishte veshur një këmishë blu me kuadrate, pantallona të zeza terital të hekurosura; këpucët i

shkëlqenin nga lustra. Si u përshëndetëm, ai mori njérën prej karrigeve dhe u ul.

Në dhomë shpejt ra heshtja. Unë i zgjata pake-tén e cigareve, po ai s'e pinte duhanin.

E merrja më mend se ky do të ishte Lili, ndryshe s'do të vinte në dhomën 201 ku kishte vetëm dy krevate. Unë i thashë se kisha folur në telefon me një vajzë që quhej Holta.

— Kur folët? — tha ai.

— Rreth orës tetë.

Lili u ngrys në fytyrë, pastaj lëshoi një «dreqi e mori» dhe heshti.

— Ju kërkova, por ju s'ishit në dhomë.

— Qeshë në shtëpi të Holtës. U mundova kot atje. Shpresoja se do të kthehej. Sot është ditë e shtunë.

— Atje punon Holta?

— Ka shkuar vullnetare një vit. Ishte punëtorë në uzinën e re. Them të shkoj nesër. U pa puna. Unë nuk flisja.

Lili hodhi një vështrim nga dritarja dhe foli:

— Tani më duhet të takohem patjetër — tha pastaj.

Unë ndeza një cigare. Lili dukej i shqetësuar.

— Më duhet të kthehem në fshatin tim — tha Lili. — Më kërkojnë me çdo kusht. Unë bëra çdo përpjekje, por kot! Tani, o të rri pa punë, ose të kthehem në fshat. Unë i thashë kryetarit të kooperativës se kishte plot njerëz, po ai ma preu shkurt.

— Keni ndonjë zanat? — e pyeta unë.

— Jam kuzhinier me kategori. E mësova në ushtri. Sa i lirova, zura punë në shtëpinë e oficera-vë. E di si më tha kryetari i kooperativës? «Ushtria të pregatiti për ne tek e fundit. Që të kryesh shërbim

min ushtarak e të vish në fshat me profesion njëko-hësisht. Ne jemi duke përfunduar në qendër të koo-perativës një ndërtesë trekatëshe. Aty do të kemi hotel, klub, restoran, si ato të qytetit. ...». Më erdhi rëndë t'i thosha se unë kam Holtën. . . Ajo. . . Si ta lë atë që unë e zgjodha pér shoqe jete?

- Ka njeri tjeter në shtëpi Holta?
- Nënën dhe vëllezër të vegjël. . .
- Bindeni plakën.
- Shumë vështirë. Unë jam fshatar. Dhe ti e kupton këtë.
- Megjithatë ti duhet ta bindësh atë.
- Ec e mbushi mendjen. . .
- Atëherë bëhuni të dy të një fjale ti dhe Holta.

— S'është e lehtë — tha ai. — Unë mund të jem burri i saj, por ajo është nëna e saj. Kushedi ç'do të thotë Holta?

Këtë pyetje e bëri disa herë Lili, derisa ne u shtrimi pér të fjetur, por ai rrrotullohej sa në një-rin krah në tjetrin. S'e zinte gjumi. Dukej që e shqetësonte Holta.

* * *

Kur u zgjova, Lili kishte ikur. Ai duhet të bën-te katër orë të mira deri në fshatin S. Rruga kalonte përmes malesh të larta. Ai ecte duke menduar pér Holtën, pér atë letrën që i kishte dërguar e ëma ku i thoshte: «Mos gabo t'i japësh fjalën kujt pér fejesë, se ta pres kokën si të zogut. Nuk të vjen turp ty vajzë qyteti të martohesh me katundar?»

Ju kujtua kur qe njohur për herë të parë me Holtën. Qe ditë e diel. Kishin aksion me goditje të përqëndruar në një kooperativë bujqësore. Do hapnin një kanal ujites. Shkoi gjithë qyteti dhe fshatrat përreth. Atje e pa Holtën! Edhe ajo e pa. I buzëqeshën njëri-tjetrit dhe të dy punuan pranë e pranë edhe kur nata mbulonte tokën, edhe kur dielli shkëlqeu fort e zogjtë filluan të cicéronin nëpër degë. Edhe kur u ndanë në mbrëmje, ata u ndanë me një buzëqeshje. Ata ishin bashkë të dy, se të dy kishin të njëjtat ndjenja, qëllime, dëshira... Pastaj rrodhën ditët e bucura plot mbresa e kujtime, derisa Holta shkoi vullnetare. Atë mbrëmje shëtitën bashkë, por Lili s'i tha gjë. Holta i foli me entuziazëm për iniciativën e tyre për të punuar një vit në ndihmë të fshatit. Ishin të gjitha shoqe. Lilit i qe mbushur mendja atë natë se Holta e kishte harruar fare, kishte harruar se në krah të saj ecte i menduar ai që e donte me gjithë shpirt. Pastaj ju kujtua nëna e Holtës. Ju bë sikur dëgjonte në vesh fjalët e saj: «Sa të jem gjallë, fëmijët e mi do të bëjnë siç u them unë. Kur të vdes, atëhere këta do të jenë irritur.»

Lili po ecte nëpër një luginë. Drejt tij po vinin disa fshatarë me kuaj të ngarkuar. Ai u përshtënët me ta dhe i pyeti për fshatin S. Fshatarët i trenguan nga do të kalonte, bile i thanë se do të bënte edhe dy orë rrugë deri në fshat. Si bëri edhe një copë rrugë, ndaloj te një krua buzë një prozhmi. Nga gurra e drunjtë uji binte në një gropë të mbushur me gjethë të rëna. Lili u hodhi syve nga ai uji i ftohët akull, pastaj piu sa ju mpinë dhëmbët.

Fshati S. shtrihej në faqe të një mali të lartë. Andej zbrisnin përrrenj të rrëmbyer sidomos dimrit.

Shtëpitë e bardha të ndërtuara me gurë e të mbuluara me rrasa dukeshin që larg dy e dy e tri e tri buzë lëndinave, pyjeve, përrrenjve, e ndanë tyre shtriheshin ca rrripa toke të mbjellur më misër. Përmes fshatit kalonte rruga. Në të dy anët kishte një mur të lartë, të ndërtuar me gurë të mëdhenj. Rrugës genë formuar ca gropë të thella si shkallë.

Dhe Lili arriti në qendër të fshatit aty nga dreka. S'dukej këmbë njeriu. Ai qëndroi në një brengore duke shikuar fshatin se mos dallonte njerëz duke punuar arave për qërimin e misrit. Tingujt e një zileje e bënë të kthente kokën andej nga shkolla. Dolën nxënësit dhe mbushën oborrin e rrethuar. Lili u afroa dhe pyeti për Holtën:

— Gjithë fshati ka shkuar në aksion për mbledhjen e patates në mal — i thanë.

— Kur kthehen?

— Kur të mbarojë patatja — thanë fëmijët dhe ikën duke ndjekur njëri-tjetrin, pastaj erdhën prapë te Lili.

— Mund të mos kthehen fare këtë javë...

— Patate ne kemi shumë — shtoi tjetri. — Më tha babai se as për një javë nuk mbarohen.

Fëmijët i treguan rruge është ai u nis për atje. Gjunjët po i dhembnin dhe trupi i qe bërë quall nga djersët. Herë pas here ngrinte sytë lart e shikonte zikzaket e rruge këmbësore tek fshiheshin në pyll e tek vazhdonin faqeve të zhveshura ku shembeshin gurë e dhera. Në të djathtë të rruge ishte një ahiste e madhe me drunj të gjatë e të drejtë me degë të lehtësuara tashmë nga pesha e gjethive, me shkëlqim të bardhë në trung e degë. Një përrua gurgullonte myturazi diku thellë në pyll. Dielli shkëlqente. Qielli ishte krejt pa re. Majë maleve frynte

një erë e ftohtë dhe e fortë. Lili u kopsit dhe u dha këmbëve. Arriti në atë pllajën midis përrrenjve kur dielli po kaptonte malet e muzgu po binte ngadalë.

Një varg i gjatë kuajsh të ngarkuar mori rru-gën poshtë pyllit. Pas tyre ecnin edhe shumë një-rez. Lili nxitoi t'u delte përpara dhe priti derisa kaluan të gjithë. Po Holtën s'ja zuri syri.

Plajës së malit kishte lëvizje. Në një anë akoma vazhdonte puna. Melodia e një këngë dëgjo-hej larg. Pak më vonë u ndez një zjarr dy, tri, dhjetë... Në flakën e tyre Lili shikonte siluetat që lë-viznin duke shkarkuar drutë. Qe nisur te njëri prej tyre, kur përpara i dolën si një tufë lule mali një brigadë të rejash. Ai pa nga ato dhe u çudit sa shumë ishin. Në krye të tyre ai dalloi Holtën. Këmbët s'i bënë më hap e sytë ju gozhduan veç në një nga ato vajza, në Holtën e tij.

— Lili! — thirri ajo.

— Holta!

— Po ti këtu?

— Erdha te ti, Holta.

Ata qëndronin me duar të shtrënguara dhe e shikonin njëri-tjetrin buzagaz. Holta qe veshur me ıroba doku, me pantallona, bluzë, me shami ak-sioni në qafë. Në duart e saj Lili dalloi jo më atë butësinë e dikurshme. Ai ja hapi duart dhe i preku kallot. Holta qeshi. Shoqet kaluan ashtu njëra pas tjetrës pa u kuptuar. Lili dhe Holta s'ja ndanin sytë njëri-tjetrit. Errësira, që sa vinte shtohej, e bënte më të madhe flakën e zjarreve. Ato ndriçonin rrëth e rrrotull edhe njerëzit, edhe këngën e tyre.

— Ja, po këndojnë edhe vajzat.

Lili pa andej.

— A e more letrën time?

Holta ngriti kokën drejt tij dhe tha:
— Po, e mora.

Po Lilit s'i mjaftonte vetëm kjo: «Po e mora». Ai donte një fjalë tjetër, që t'ja qetësonte zemrën e ngritur peshë.

— Pse interesohesh pér letrën kaq shumë. Nëna thotë të vërtetën. Ti a nuk je «katundar»? — pyeti ajo duke qeshur.

— Holta! — dhe sytë ju ngrinë në fytyrën e saj të bukur, në buzët e saj të çelura përgjysmë. Dhe priste më kot të dëgjonte përgjegjen me fjalë. Holta ju hodh në qafë...

Pas pak ata u nisën dorë pér dore drejt zjarrave ku këndonin të rinxjtë.

KUR GJUHEJ GURI NË SHENJË

Fatimja punonte në brigadën e blegtorisë. Ish-te mjelëse. Gjithë fshati e mbante në gojë për dy gjëra: Se ishte shumë punëtore dhe gjithmonë qëndronte në tabelë të nderit dhe se pikërisht kjo Fatimja punëtore dashurohej me atë çapkënin, Ganiun, bariun e deleve që rrinte tërë ditën e ditës duke kënduar.

Nënë Xhija i dinte marrëdhënjet e Fatimesë me Ganiun. Ajo priti derisa erdhi Asllani me leje. Ju afrua të birit dhe e pyeti:

— Djali i nënës! Dua të bisedoj një gjë me ty. Fatimja e do Ganiun. Kjo mund të na turpërojë në fshat. Ti e di zakonin. Nëna jote ka ardhur gjashtë orë larg për t'u martuar këtu.

— Po Fatimja ç'hotë?

— Thotë se ata duhen dhe se i kanë dhënë fjalën njëri-tjetrit. Do të martohen.

— Po qe kështu, o nënë, s'ka pse të ketë turp. Çdo i ri zgjedh shokun e jetës. Kështu thotë Partia...

— Po fshati, ç'do të thotë?

— Fshati nuk janë dy, apo tri veta, fanatikë e llafazanë që merren me thashetheme, nënë, po janë komunistët, rinia dhe mbarë populli.

Dhe nënë Xhija s'e bëri të gjatë që atë ditë që

bisedoi me Asllanin. Ajo e donte Ganiun, si Asllanin.

Po fjalët nuk pushonin. Kur u hap lajmi se do të bëhej dasmë të dielën, të gjithë u bënë gati për të shkuar, disa, dhe këta ishin shumica dërmuese, për të bërë qejf e për të gëzuar bashkë me çiftin e ri e disa të tjerë për të shuar kureshtjen në atë dasmë të re.

*

* * *

Dhe e diela erdhi. Mëngjezi ishte i bukur, si çdo mëngjez pranveror. Era e luleve dhe e barit të njomë ndjehej kudo. Zogjtë ciceronin të gëzuar e tek fluturonin zhdukeshin në degët e pemëve të lulëzuara. Fshati kishte lëvizje. Bulëzat e vesës shkëlqenin mbi barin e njomë, mbi grurin e ri që rritet tërë shëndet nëpër ara. Lumi gurgullonte anës bregut, se ende nga malet zbrisnin përrunjëtë me ujë të ftohtë. Shkrihej bora.

Midis atyre të rinjve qe vështirë të dalloje çiftin e ri. Ata kalonin mes përmes fshatit duke kënduar. Vargu i tyre i gjatë sa vinte e shtohej deri atje lart mbi kodër përtej lumit ku nxitonin të rinjtë e brigadës së shtatë e deri te garazhi ku qenë mbledhur e prisnin të tjerë... Fëmijët vraponin duke thirrur: «Erdhi nusja, erdhi nusja». Midis të rinjve ishte edhe nënë Xhija. Ajo ecte me kokën lart. Fytyrën ja kishte pushtuar gëzimi i asaj dite. Pas saj ishin të rinj të tjerë, të cilët patën përgatitur me ngut atë orkestër që për nga numri i veglave ja kalone të çdo orkestre dhe s'linte melodi pa marrë, si

t'ua donte qejfi tē rijnve. Ata ecnin e këndonin. Nënë Xhija u buzëqeshte këngëve. Anëve tē rru-gës ndonjë sy zgurdullohej.

— Ç'kohë që erdhën! — tha dikush.

— Ç'kohë! — tha nënë Xhija dhe ra në mendime. Asaj ju kujtua koha e dikurshme. «Qe ditë e enjte. Më në fund babai caktoi ditën e dasmës, caktoi vendin ku do tē takoheshin. Në kodër tē varreve, në një livadh në mes tē pyllit, qe caktuar pikëpjekja. Unë fillova tē qarat, ndërsa tē tjerët përgatitjet. Qava aq shumë, sa në jetën time s'kisha qarë kurrë. Isha pesëmbëdhjetë vjeç. Më bënë nuse. Më hipën në kalë dhe u nisëm. Dy kuaj tē ngarkuar me pajën ecnin përpara. Më mbanin për krahësh se mos rrëzohesha. Unë qaja, po askush s'i shikonte lötët e mi, që qullnin edhe perçen e kalit dori. Po martohesha me një njeri, që s'e njihja. Edhe ai s'më njihet...»

Kolona e gjëzuar e tē rijnve mori rrugën në tē djathtë. Ku shkonte vallë? Salla e madhe ishte në vatrën e kulturës. Atë e kishin lënë pas. Mbështetje shtëpia e Ganiut? Jo. Ai s'e kishte shtëpinë atje. Te shtëpia e asaj «shtrigës» mbështetje...

Rrugëve kishte filluar tē ngrihej pluhuri, se gjithë ato ditë kishin kaluar pa shi. Në pemët e mbushura plot me lule dëgjohej zukatja e bletëve tek thithnin nektarin e ëmbël.

Të rinxjtë i futi në gjirin e saj një lëndinë e bukur e rrëthuar me mollë e me dardhë, ku rritheshin për bukuri ato kumbullat tropojane, ku ishte ai mani i madh, nën degët e tē cilit mund tē rrinë në hije dyqind shpirt, ku bari i njomë ja kalonte çdo qilimi, ku kroi i ftohtë buronte atje pranë në rrënje tē lajthisë.

Fëmijët hipën lart mbi pemë, herë duke kënduar, herë duke vërshëllyer e herë duke pështyrë ato kumbullat e vogla sa një sumbull, që ishin helm të hidhura.

Daullja kërciti fort tri herë e qetësia u vendos. Dëgjohej vetëm kënga e zogjve nëpër pemë që s'donin t'ja dinin as Cafes, as daulles së tij.

Në një qoshe mbi një mur të vjetër, prapa të cilit qe ndezur zjarri, ishin ulur tre burra të moshuar. Ata ishin të vetmit spektatorë në dasmë, të vetmit që nuk hanin, as pinin asgjë e që e prisnin bajramin të uritur së tepërmë.

— Shif si këndoka edhe nusja.

— Allah, allah! Luej prej vendit.

— S'po u besoj syve se ç'po shoh.

— Shife edhe shtrigën Xhije me gotë të rakisë përpara.

— E pse jo. Se mos e pagoi shtrenjtë.

— U prish dynjaja për nur të allahut. Po ti shikojë Shytin, more, Shytin me thinja në kokë. S'i vjen turp qafirit me u ba si kalama.

— T'ja marrë dreqi burrninë, t'ja marrë!

Nënë Xhija shikonte e mendonte dasmën e saj:

«Ne duhet të arrnim të parët në vendin e caktuar, pastaj krushqit. Nxitonim se ishte larg. Mua më fshehën në një qoshe të pyllit larg krushqve. Filloi muhabeti. Ndërronin duhan simbas zakonit me njëri-tjetrin. Dhe të gjithë prisnin të fillonin gjuajtjen e shenjës me pushkë. Njerëzit e nuses do ta ngrinin gurin ku të donin e si të donin, ndërsa krushqit do ta qëllonin me çdo kusht.

— Shkoni e na ngrini një gur, o bij — u kiste thënë babai djemve.

— E kemi ngritur — tha një zë.

— Kush e ngriti?

— Unë e ngrita — tha Seiti i Canëve.

Babai e kishte vështruar me dyshim, por kishte heshtur. Si të bënte ndryshe. Ai gur qe ngritur dhe s'lëvizte veç me plumbin e pushkëve. Babai e dinte se Seiti i Canëve kishte gjetur rastin për të futur ngatërrresën. Me atë kishte filluar një hasmëri që kur kishte kërkuar njëren nga ne të dy morat e babai s'kishte pranuar.

— Ku është vënë guri — pyeti i pari i krushqve.

— Ja, atje afër një dëllinje në majë të kodrës

— tregoi Seiti i Canëve.

Guri i shenjës ishte vënë aq larg, sa me pushkët e atëhershme qe e pamundur të qëllohej. Pa e kishte vënë në atë drejtim që edhe dielli t'u binte në sy kur të merrnin shënim.

Krushqit u shqetësuan kur e panë, por s'kishin se ç'të bënin. Guri duhej qëlluar me çdo kusht. Zgjodhën shenjuesit më të mirë e më të zotë, por ata s'e qëllonin dot.

Seiti i Canëve gëzohej.

I harxhuan fishekët që patën gati të gjithë. Dërguan dhe kontrolluan gurin se mos kishte ndonjë magji, por më kot.

— Gurit t'i bënin magji!?

— Po, gurit. Thoshin se, po t'i vihej gurit bukë, nuk e qëlloje dot, se bukës i shmangen plumbat.

Më në fund u hoqën shpresat, se atë gur mund ta qëllonte njeri. Nata po afrohej... Ç'të bënin? Zakoni ishte zakon... Kur nuk qëllohej, guri duhej t'i ngarkohej kalit të nuses.

Guri ishte aq i madh, sa, po të mos isha unë e lehtë pendë pule, kali nuk do të na ngrinte të dyve as dhjetë hapa nga ai vend».

Të rintjtë qeshën.

Nënë Xhija u shkund nga kujtimet. Ajo buzë-qeshi lehtë dhe ra përsëri në mendime.

Orkestra mori një melodi popullore. U ngritën të rintjtë, djem e vajza e ja morën valles aq me nxitim, sa unë bëra hesap me veten time se do të mjaftonin pesë minuta që ato të lodheshin e të ule-shin në vendet e tyre. Po u gabova, se pas asaj valleje filloj një e dytë e pas asaj një e tretë e në vend që të uleshin, u ngritën edhe ca të tjerë e tryezat mbetën gati të zbrazura. E do të vazhdonte gjatë ajo valle e pakëputur akoma sikur të mos thyhej ajo thupra e hollë, me të cilën e rrihte Cafa daullen me dorën e mëngjér. E nga kjo plasën të shara e mallëkime, po Cafa as i dëgjoi e as ua vuri veshin dhe, kur të rintjtë qenë ulur në tryeza e po ngrinin gotat për shëndetin e nënë Xhijes, ai i ra daulles fort dhe lajmëroi «gatishmërinë». Të tjerët panë nga ai dhe kur ja vështruan djersët që i rridhnin në ballë i buzëqeshën e kur e ngriti gotën i thirrën: «Gëzuar» e kur u ngrit në këmbë i thanë: «Një për xha Shytin».

Dhe plasën të qeshurat.

Që prapa murit të vjetër dilte tymi e ai ngrihet mbi kokën e atyre tre burrave dhe zhdukej lart në ajrin e pastër ku s'arrinin as degët e manit të bardhë...

Cafa me lodër, Ibishi me xingonë e bënë të digjët plakun. Xha Shyti përdridhej me një shami të bardhë në dorë. Sa e donte atë:

«Se qava, moj none, ku je...»

Nga muri i vjetër ku qe ndezur zjarri folën:

— Ta marrë dreqi burrin, ta marrë!

— Mos mallëko në ramazan.

— Lene ma, se...

Po xha Shyti kërcente e këndonte si djalë i ri. Apo s'e mbante në dorë atë faqoren e tij plot me raki, të cilën e kthente herë pas here pa e ndalur kërcimin. Po ngriheshin nga tryezat të rintjtë dhe ja mbushnin pak si tepër gojën me meze e këtu puna ngatërhojej pak, se xha Shytit i mungonin shumë dhëmbë. Të rintjtë duartrokisnin e plaku rrrotullohej e rrrotullohej. Qeleshen e kishte hequr fare e me shami fshinte djersët. U afrua ashtu në kërcim e sipër te muri i vjetër ku qenë ulur të tre burrat. Ata e vështronin me inat e përcëmim, turfullonin në hundë dhe diç pëshpërisnin. Plasën të qeshura. Xha Shyti ju afrua tryezës së parë, tërroqi xha Rizanë dhe një djalë të ri dhe ja morën valles së brezave ashtu siç e kishte «lezetin».

Por nënë Xhija kujtonte natën e errët të dasmës së saj.

«Ra nata. Rruga qe e largët dhe e vështirë. Një njeri më mbante mua, dy veta gurin e dy të tjerë kalin që të mos rrëzohej e të na hidhte në honet e errëta...

Kishte kaluar mesi i natës kur arritëm në shtëpi.

Ne u futëm brenda. Guri në oborr. Guri i shenjës.

Rrohdhën vitet... Po guri i shenjës nuk u harrua. Atë e shikonin sa herë që hynin apo delnin nga shtëpia. Ai gur ishte në mes të oborrit tonë. Ai gur e bënte të rrinte kokulur tim shoq. Edhe fshati fliste për atë gur, se ai gur u kishte shkaktuar kokëçarje edhe atyre. Po mbi të gjitha, turpin e lante gjaku. Pra duhej të vritej dikush nga prindërit e mi. Të gjithë qenë dëshmitarë se as babai, as

vëllezërit e mi nuk kishin faj për atë gur. Fajtori dihej, prandaj duhej vrarë Seiti i Canëve. Kush do ta vriste tjetër veçse im shoq. Unë nuk dija as gjë, por frikën ja kisha kësaj pune. Një natë, kur po çaja dru në oborr, e pashë tek po vinte rrugës fytyrëngrysur me pushkë në krahë.

— Grua, e vrava Seitin e Canëve — më tha.

Unë nuk bëzajta, sado që e dija se q'më gjeti mua dhe atë. Seiti i Canëve kishte tre vëllezër si ujqër.

— Ti duhet të ruhesh, o burrë.

Ai më shikoi buzagaz dhe më tha:

— Të zgjodha shtëpi pushke, por ti qenke frikacakë.

E mbylla gojën. Ç't'i thosha, sado që isha e sigurtë se do ta vrisnin për të marrë gjakun. Dhe e vranë... Ç'kohë!»

Nënë Xhija ngriti kokën e vështroi lart nga mali ku bagëtitë kullotnin, bilbilat këndonin dhe lulet rriteshin e shtoheshin tanë në ditët e ngrohta të pranverës.

Kënga vazhdonte.

Sheshi ku kërcenin qe zënë fare. Kënga e zogjve mes luleve të çelura mezi dëgjohej.

Dielli qe gati në të perënduar. Hijet e maleve të larta binin mbi fshat duke i dhënë gjelbërimit një ngjyrë të re.

Vajzat kërcenin me Fatimen në krye, kërcenin një valle të kënduar.

NJË KËNGË QË DO KËNDOJA UNË

U ndodha në një festë të madhe, në festën e dritave. Elektrifikimi i gjithë fshatrave të Shqipërisë përfundoi. Kooperativa kishte festë.

Po afrohej mbrëmja.

Atë natë do të shkonim tek Agimi. Po nuk isha vetëm unë. Erdhën edhe të rinj nga fshati, një mësues e dy mësuese. Gjithë e gjithë sosëm në shtëpi dhjetë veta, se Agimi qe me gjithë të shoqen. Po, kur e morën vesh ata të fisit të Agimit, u ngritën me të madh e me të vogël. Falë dhomës që ishte tētë me tetë, se kallaballëku qe i madh.

Shtëpia kishte një verandë ku qenë varur pjergulla. Në oborr gurgullonte gurra e madhe ku fillonte një prozhëm i vogël, e në vazhdim malet e larta me kurrise të zhveshura.

Pastaj na shtruan darkën pa vonuar.

Filloi kënga. Që në fillim unë e kuptova se ata të rinj jo vetëm që këndonin bukur, por edhe dinin çdo lloj këngë. Pa fjalë ata e dinin rregullin e këngës. Ja merrte njëri, të tjerët e shoqëronin. Fillonte i pari, i dyti e kështu me radhë... Pra secili do këndonte një këngë në atë rrëth. Ja merrte edhe plaku, xha Pjetri, dhe të tjerët e shoqëronin. Edhe unë këndoja me ata.

Pastaj ata kërkuan të këndoja unë një këngë. Ata prisnin që unë të filloja një këngë, atë që të doja e «ashtu si dija» e ata të më ndihmonin me zërat e tyre të bukur e të fuqishëm. Unë mendoja se ç'këngë të merrja e për fat të keq s'po më kujtohej asnjë këngë nga ato që dija e që nuk ishte kënduar atë natë. Nga kjo unë kisha harruar fare se si këngëtar nuk ja thosha. Po ja që u dashka edhe zëri, edhe kënga. Të them të drejtën u ndodha ngshtë. Unë i kuptoja ato vështrime të shokëve e të shoqeve që më rrethonin nga të gjitha anët. Pastaj mendja ime fluturoi nga ajo dhomë qindra kilometra larg aq shpejt, sa s'gjej dot masë për ta matur, as shifër ekzakte për ta shënuar. Më dolën përrpara male të larta e lumenj të rrëmbyer, fshati im dhe shkolla ku kisha mësuar shkronjën e parë e kushedi sa këngë. Pra më mbetej veç të filloja këngën. Harrova fare se rrëth meje ishin shokë e shoqe. Zëri im mbushi dhomën si asnjëherë tjetër. Po asnjë nga shokët as shoqet nuk po këndonte. Kjo më bëri të mendoja, por këngën e vazhdova deri në fund pa m'u hequr nga mendja për të gjetur psenë e heshtjes së shokëve. I bëra një kontroll zërit tim. M'u duk më i bukur se asnjëherë tjetër.

Ata më shikonin të kënaqur.

— Na kënaqe me atë këngë, o Shkëlzen — tha Xhelali.

— Nuk e ndihmuam asnjëri...

— Të them të drejtën unë di shumë këngë partizane, por atë jo — tha Agimi.

— As ne të tjerët nuk e kishim dëgjuar.

— Ajo është një nga këngët e para partizane, këngë popullore. Populli i çdo krahine ka këngët

e tij, që ua ka kënduar partizanëve — thashë unë.
— Edhe kjo këngë ka historinë e saj. Dhe fillova
t'ua tregoja.

*
* * *

... Dhe nata qe trembur nga krismat e push-këve e të mitralozave, nga plasja e bombave të dorës dhe e predhave të mortajës. Bëhej luftë e rreptë. Xhandarë e milicë thoshin se ishin me qindra, ndërsa partizanët një çetë. E sa partizanë mund të ketë një çetë, askush s'e dinte, por me mend e merrnin se do të qenë fare pak në krahasim me ar-mikun.

Nata ishte e errët. Frynte veriu. Gjatë gjithë ditës kishte rënë shi e përrenjtë, të rritur, gurgullo-nin me zhurmë. Në atë qafë mali kishte vetëm tri shtëpi në një oborr. Poshtë shtëpive kishin një rrip toke, që, sa herë rritej, ai përroi i rrëmbente nga një copë. Ata s'kishin ç'thoshin, veçse përsëris-nin shprehjen e tyre të pérherershme: Ara shkau në përrua. Në ato shtëpi s'kishte këmbë burri veçse një plak që i kishte kaluar të shtatëdhjetat. Djem-të kishin ikur. I prisin, po ata s'po ktheheshin. Kështu plakut i takonte të kujdesej për të tri shtë-pitë, se ishin të një fisi, të një zjarri. Të gjithë fë-mijët e gratë i thërrisin xha Banit babë. Punët e shtëpisë i bënин gratë. Ato shkonin edhe në pyll për dru e për krandë lisi e ahu, se mullari i kashtës mbarohej shpejt e bagëtitë s'kishin me se t'i ush-qenin.

Atë natë nuk mbylli sy njeri në ato tri shtëpi,

se lufta bëhej në oborrin e tyre, në arë, në përrua e më larg deri rrëzë pyllit ku mbushnin ujë për të pirë. Xha Bani doli dy-tri herë në derë të shtëpisë. Dëgjoi vërshëllimën e plumbave, erën e barutit të djegur e u kthye në dhomë duke psherëtirë, se nuk i punonte as dora, as këmba, as syri.

Veriu ulurinte e qeni lehte si i tërbuar.

— Futeni atë qen brenda — u tha plaku nuseve.

Ato u çuditën. Në një natë të tillë qeni të mbyllej brenda!

Xha Bani i pa që s'lëvizën dhe u tha:

— Po të vijë armiku, qenin e pret plumbi... Si heshti ca, vazhdoi.

— Mbase vjen ndonjë mik e vonohet përjashtata. Nata është e ftohtë.

— Sonte s'vjen njeri për mik, babë. Natë si kjo unë nuk mbaj mend — i kishte thënë njëra nga nuset.

— Miqtë në net të vështira vijnë, o bijë, po lidheni qenin.

Kaq kishte thënë plaku e kishte heshtur.

Dy nuset dolën në oborr. Errësirë. Po binte borë. Qeni, sa dëgjoi derën e shtëpisë, që u hap, u sul oborrit duke lehur. Të dy nuset ju afruan. Ai kaptoi gardhin dhe u fut nëpër ca shkurre. I folën në emër, po qeni veç egërsohej më tepër.

— Diçka sheh — tha njëra nga nuset.

Qeni u hodh përpara duke lehur, pastaj angulliu duke u zmbrapsur si ta kishte goditur dikush në kokë me gurë. Nusja u afroa, e kapi qenin pas qafës dhe e tërhoqi zvarrë. Po nuset ndaluan. Ato sikur dëgjuan një pëshpëritje. Një vetëtimë çau

çiellin. Ato panë një shkurre që lëvizi. Dëgjuan një zë të dobët, që mezi vinte deri tek ato:

— Motra!

Qeni filloi të lehte përsëri dhe mundohej t'u shpëtonte nga duart. Nusja e vogël vrapi oborrit.

— Baba, te gardhi i kopshtit në shkurre është dikush — tha ajo duke ju marrë fryma.

Nusja printe përpëra e xha Bani e ndiqte pas duke u mbajtur fort pas shkopit. U futën në shkurre, por as panë e as dëgjuan gjë.

— Mos ju bënë veshët? — pyeti plaku.

— Jo, baba, ne pamë shkurren që lëvizi. Dëgjuam të na fliste. Ja atje — dhe tregoi me dorë dy-tre hapa larg tyre në errësirë.

Plaku bëri përpëra, por nusja shtangu në vend.

— Një njeri.

Xha Bani ju afrua, e preku në rroba, i kishte të grisura; e preku në flokë, i kishte të qullura; e preku në ballë, ju bë se preku akullin. I futi dorën në gjoks, por dora i ndeshi në pushkën e tij.

— Ngrijeni shpejt — u foli nuseve plaku dhe mori udhën pas tyre duke hedhur këmbët me hamendje në errësirë.

— E patë? Është gjallë? — pyeti xha Bani sa hyri në dhomë.

— Po baba — thanë nuset njëzëri.

— Afrojeni në vatër. Hidhini zjarrit dru të tjera. Mbylleni derën me lloz. Sillni një palë rroba të djemve — urdhëroi plaku nuset dhe vetë ju afrua partizanit.

— Gjak! Në kofshë ka një plagë të thellë — tha nusja e vogël.

Gjaku i rridhete gjithnjë dhe krijoi një si pellg tē vogël nē vatér. Xha Bani largo i nuset e ju afraua vëtë duke picërruar sytë. Si e pa plagën, thirri:

— Shpejt ca gjizë tē pakripur!

Pushkët kërcisin aq afér, sa nē fillim kujtuan se ishin nē derë tē shtëpisë. Oxhaku bënte tym dhe plakut i rriddhnin lot nga sytë. Mezi e shikonte plagën.

— Afrohu ti, nuse, veç mos ja lëndo plagën.

Nusja ja lidhi plagën, po shpejt gjaku e skuqi bezen e bardhë.

Ata i ndejtën gjithë natën mbi kokë. Afér mën-gjezit, kur xha Bani me tē dy nuset po ja ndërronin plagën, partizani hapi sytë dhe pëshpëriti lehtë:

— Sho... k... ë....t...

Dhe ra përsëri nē kllapi.

*
* *

Mëngjez i ftohtë. Qielli ishte krejt i zënë. Xha Bani ecte nëpër oborrin e shtëpisë. Bora nuk ja mbulonte opingat. Ai ishte i sigurtë se do binte prapë.

Patrulla milicësh e xhandarësh endeshin poshtë e lart duke kontrolluar vendin. Në sfondin e bardhë tē borës ata dukeshin si korba. Forcat e shumta nuk dukeshin, se akoma rrinin tē fshehura nëpër përrenj, tē gatshëm pér tē hapur zjarr, mbasi ende s'e kishin hequr dyshimin se partizanët do tē qenë atyre anëve dhe veç mjegulla e dendur mund t'i pengonte se ata do tē shikonin çdo veprim tē tyre.

Po se mund të ishin partizanët, ata s'e përcaktonin dot. Nuk dihmoi fati. Bora kishte filluar të binte pikërisht kur partizanët kishin çarë rrëthimin dhe ishin tërhequr në pyll.

Plaku mbahej pas shkopit dhe, sado që të iu tét therës i çonte të dredhura, s'i bëhej të futej brenda. Herë mendonte partizanin e plagosur, herë djemtë e tij që nuk dinte se ku ndodheshin e si ndodheshin.

— Baba, te plepi në breg të arës sonë është një njeri. E pashë nga çatia. Ai mezi dallohet, se është fshehur pas trungut në ca shkurre. Duhet të jetë partizan.

Nusja e vogël heshti dhe plaku i menduar, pa kthyer, kokën pëshpëriti:

— Ditë... armiqqtë... si t'ja bëjmë?

— Do ta kapin, babë, do ta vrasin...

— Pusho, gjuhëgjatë!

Nusja uli kokën.

Plaku, si mendoi një copë herë, foli me zë të ulët duke e shikuar nusen drejt në sy:

— Merr litarin, bijë, e shko merr kashtë te muillari. Mos kalo afér plepit, herë pas here vështro me kujdes që të mos të kuptojnë.

Nusja nuk lëvizi nga vendi.

— U zemërove me mua, bijë? — pyeti plaku.

— Jo, baba, por atje kam frikë të shkoj.

— Ke frikë? — u habit plaku.

— Po, kam. Jo nga pushka e tyre, por...

— Eja pas meje pra — tha ai pas pak.

Të dy njëri pas tjetrit morën udhën përmes arës. Plaku, duke u mbajtur fort pas shkopit, dhe nusja e vogël duke hetuar vendin. Po s'kishin bërë

as dyqind hapa, kur nga bregu i ~~nëm~~^{ndëshkimi} dëgjuan një zë të egër:

— Ndal!

Ata panë andej dhe dalluan një skuadër xhendarësh përballë tyre. Njëri nga ata, një trashaluq me trup të shkurtër e barkdalë, me mustaqe të gjata e të zeza si pendë korbi, u kërcënohej:

— U kanë plasë sytë e ballit-a? Zjarri i ndezur e ju shkon drejt tij. Po a s'e dini se zjarri ju djeg? Ju janë shurdhuar veshët e nuk dëgjoni ç'luf-të po bëhet? E kjo luftë i ka futë tmerrin partizanit (Plaku këtu shau). Kthehuni prapa, se për pejgamber, or plak matuf, më vjen ndot të të vrás, o të...

— Dhe e shau keq xha Banin. Xhandarët qeshën dhe priten që plaku të kthehej pa bërë zë.

Xha Banit i kishte kërcyer deli në ballë. Po hapte gojën, kur nusja ju afrua te veshi:

— Baba, mos u grind, për hatër të partizanit. Ata janë të poshtër, ti vetë më ke thënë.

Këto fjalë ja mbyllën gojën xha Banit, sado që gjoksi i tij ulej e ngrivej me forcë.

Të dy u ngjitën në çati dhe, si i hoqën ato shkallët e vëna qëllimi, ju afruan partizanit që kishin fshehur atje. Ai rrinte me sy të mbyllur. Fytyra e tij dukej shumë e verdhë. Nën sy i qenë formuar rrathë mavi. Nusja ja rregulloi jorganin rrëth trupit dhe u afrua te plaku që shikonte nga ajo frëngjia e vogël në çati.

— Ja një patrullë tjetër, baba. Po kalon në fund të arës. Ata janë aq afër plepit, sa çudi si nuk e shohin partizanin.

Plaku nuk fliste.

— E panë. Ndaluan të gjithë në vend me sy të ngulur te plepi i gjatë.

— Po — tha xha Bani.

Xhandarët e rrëthuan plepin dhe filluan të afroheshin aq më kujdes, sikur para tyre kishin një qendër zjarri të betonuar. Si bënин dy-tri hapa, qëndronin dhe, vetëm pasi siguroheshin se partizani nuk bënte as më të voglën lëvizje, afroheshin.

— Mund të jetë i plagosur rëndë ose i vrarë.

Pastaj nusja e vogël mbylli sytë.

U dëgjuan njëra pas tjetrës dy krisma, dy bomba dore që plasën, ja atje rrëth plepit të gjatë. Në ajër u ngritën copëra dheu e bore. Partizani që ngritur përgjysmë, kur ju hodhën përsipër katër xhandarë, që kishin shpëtuar nga copërat e bombës.

Dhe ara dukej si e plagosur. Dy gropë qenë hapur, dy gropë të rrëthuara me kufomat e të vrasëve. Të katër xhandarët e hoqën zvarrë partizanin.

Nga të gjitha anët shpërthyen breshëritë. Xha Bani e nusja kujtuan se po fillonte përsëri beteja. Në pak minuta vendi u mbush plot me xhandarë e milicë që shikonin të frikësuar pyllin e mbuluar nga mjegulla e dendur.

* * *

— Zgjidheni! — urdhëroi një oficer trupgjatë e thatim më dhëmbë floriri. Ai rrinte ftyrëngrysur, me duar të lidhura pas shpine. Pastaj bëri një shenjë. Dikush u gatit përparrë oficerit dhe urdhëri u zbatua aty për aty. Përballë partizanit, jo më larg se dhjetë hapa, u rrjeshtua një skuadër me armë pranë këmbës.

Krismat e bombave e të pushkëve e bënë të hapte sytë partizanin e plagosur. Xha Bani e nusja e vogël i futën krahët. Ai, sa e pa, e njohu shokun e tij.

— Guri — pëshpëriti ai. — Po e pushkatojnë — tha partizani papritur. — Qëndro, vëlla...

Nuses së vogël i shkëlqyen sytë nga këto fjale. Xha Bani me ballë të vrenjtur e nofulla të shtrënguara shikonte nga frëngjité dhe mendonte.

— Duhet shpëtar — tha.

Ata të tre vështronin dhe diç bluanin. Ndërsa në arë rrinin ata, ai dhe ata.

Oficeri gjatosh me dhëmbë floriri ju afrua partizanit dhe e pyeti:

— Çfarë jeni ju.

— Partizan — thirri trimi aq shumë, sa u dëgjuat larg.

Oficeri qeshi.

— Ku i ke shokët? — i tha ai.

— Në mal, në fusha e kudo — tha partizani dhe buzëqeshi.

— Dëgjo — tha ai. — Mos bëj të tilla pyetje. Unë do të të kisha vrarë ty menjëherë. Dëgjon!

Oficeri italian nuk kuptoi se ç'i tha partizani. Ai vuri dorën në pistoletë dhe ndërkokë u dëgjuan dy të shtëna njëherësh.

Oficeri i gjakosur u këput e ra përtokë. Të tjetrët e kuptuan se qëllonin nga shtëpia. Prandaj dhe doli kënga.

«*Ajo shtëpi përmbi greminë
plumb ka muret, barot çatinë».*

Dhe lufta u ndez e ashpër Nga frëngjité e asaj shtëpie dëgjoheshin të shtëna sikur brenda saj të genë tridhjetë trima. Por ata ishin vetëm tre: xha Bani, partizani i plagosur dhe nusja e vogël. Po ajo nusja e vogël që shoqëronte xha Banin. Dhe për atë lindi kënga:

.....

*«Nuse e vogël, ç'mendon ti?
T'i shpëtoj trimat në gjë,
si duhanin armiqt t'i gri*

.....

Mjegulla varej gjithnjë e më shumë ndër lugina. Xhandarët e milicët kishin rrëthuar shtëpi-në nga të gjitha anët. Plumbat kalonin përmes dritareve të vogla dhe pas rikoshetave që bënин në muret e gurta binin në dysheme copëra dheu, gurësh, plumbash.

*«Qëllo mirë, o partizan,
mbahu burri fortë, xha Ban,
Kur të rridhka gjaku ballit,
të vjen pranë nusja e djalit.*

Por më në fund dy xhandarë arritën t'i vinin zjarrin një mullari me bar që ishte në fund të oborrit. Tymi mbuloi shtëpinë. Armiqtë u sulën përpalla. Flaka u ngrit në qiell, por të shtënat nuk pushuan për asnjë çast.

Ata të gjithë u dogjën atje. Ndaj thotë kënga:

*Nxijnë ushtria përmbi borë
Flakë shtëpia si kurorë
Në mes të arës një zemër trime
Ja ku është Partia ime*

— Kjo është kënga e xha Banit. — tha një prej të rinjve.

— Xha Bani ishte dhe luftëtar dhe këngëtar — thashë unë. Qysh atë ditë kjo këngë u këndua. Atë natë këtë këngë e mësuan të gjithë.

NJË PALEË OPINGA

Si mbarova Institutin e lartë bujqësor, u cak-tova në kooperativën e bashkuar «Partizani».

Rruja qe e parrahur nga maqinat, por megjithatë, mbas nja dy orësh arrita në kooperativën «Partizani».

Bashkëfshatarët e mi më përqafonin e nga të gjithë dëgjoja fjalë të tillë: «Na harrove fare. Marshalla, tani që u bëre burrë, na harrove rrugën e fshatit, pa lëre shtëpinë!..»

Pas disa ditësh u bë mbledhja e asamblesë. Salla u mbush aq shumë, sa të merrej fryma. U dha raporti vjetor i kryesisë dhe pas tij u bënë tridhjetë e ca pyetje, shumica e të cilave u prit me fjalët: «i sqaroi rapporti këto», por ata këmbëngulnin: «Nuk e kuptova mirë».

Përgjegjja e pyetjeve u dha. Dukej qartë se ata që bënë pyetjet, nuk kishin mbetur aq të kënaqur, prandaj edhe sa u tha: «Fillojmë nga diskutimet», u ngriten shumë duar përnjëherësh. Të gjithë diskutantët arrinin në përfundimin se kooperativa e tyre duhej të ecte përkrah kooperativave të tjera. Të paktën të gjithë theksonin se kishin kushtet edhe përvojën, por mungonte organizimi i punës e shumë e shumë të tjera...

— Kalojmë në zgjedhjen e kryesisë së re.

Ishte paraqitur një listë prej njëmbëdhjetë veta. Kur dëgjova emrin tim në atë listë, unë u çudita. Nuk dija gjë. Pastaj filloi diskutimi i të gjithë atyre që propozoheshin në listë.

— Për Ilir Dushkun kush ka për të folur?

Qetësi. Unë rrija kokulur duke shkarravitur në një copë letër. Në mes të sallës unë pashtë Çal Çalibin, kulakun e dikurshëm. Ai më buzëqeshite, por mua ajo m'u duk më tepër ngërdheshje se sa buzëqeshje.

— Ta hedhim në votë?

— Kundra? S'ka. Mbetet në listë.

Më në fund kryesia e zgjedhur me pesë shoqe e gjashtë shokë doli mënjanë për të zgjedhur kryetarin... apo kryetaren...

Që nga ajo ditë kanë kaluar muaj. Punët shkojnë përgjithësisht mirë, por ne shprehemi nëpër mbledhje: «Jemi të ndërgjegjshëm se akoma kemi shumë për të bërë».

Ishte ditë e bukur dhe e ftohtë. Po shkoja në brigadën e tretë për të parë se ku ishin e si shkoni me punën e shtretërve të nxehjtë.

Qe hera e parë që në kooperativë po pregetitëshin shtretërit e nxehjtë.

Hamdi Vathin e takova duke ju ngjitur një kodre të zhveshur. Ai, sa më pa nga larg, më thirri:

— O, mirë që të gjeta, se te ti qeshë nisur, o kryetar.

Pastaj ndezëm nga një duhan e Hamdiu vazhdoi me atë zërin e tij të shterrur.

— Për besë ti s'po rri në zyrë e na kena punë me ty.

— E ç'punë ke ti, o Hamdi.

— Kam dasmë të dielën, o kryetar. Martoj djalin. Edhe dy ditë kanë ngelë.

— Të trashëgohet djali — urova...

— S'asht këtu puna, o Ilir. Unë qeshë nisë te ti për dy gjana, e para për të të ftue në dasmë dhe e dyta me të pyetë një diçka. — Ai heshti.

— Për çfarë?

— S'di a ta ftoj Çal Çalibin?

— Të mbetet merak.

— Jo, more, por s'di ç'do thotë mileti.

— Për ish kulakun?!

Ai më shikoi e nuk më dha përgjegje.

— Populli vetë e bëri kulak, o Hamdi. Ky po-pull ja hoqi triskën e frctnit.

— Po, ashtu asht.

— Mos mendo ma gjatë.

Dhe u ndamë me Hamdiun.

Ju afrova bregut të lumit. Për dreq një takim i pakëndshëm më priste atje... Çal Çalibi më kish-te parë nga larg e po priste që të afrohesha...

Frynte një erë e ftohtë. Unë ngrita jakën e xhaketës ngaqë isha i djersitur. Malet pérreth që-në nxirë. Retë vraponin qiellit si të nxituara. Çali mbështolli një cigare e ma zgjati, po unë e prita me një: «Faleminderit, éshtë duhan i fortë, s'e pidot».

Fytyra e tij e parruar, me mustaqe të gjata e të thinjura deri te veshët, nxinte. Sytë e tij rrinë të fshehur nën ato vetulla leshtore.

— Desha me të pyetë se çfarë ke me mue, o Ilir? — u dëgjua zëri i Çal Çalibit. — Që kur ke

ardhë këtu, jo vetëm që s'ma ke hangër bukën, por as më shikon me sy. Ti s'duhet të harrosh — ngriti zërin Çali — se ajo buka ime të ka rritë e ba kaq. Unë të mora i pari kur të vdiqën prindërit e nege jetim. Bukën. Mos ma përbuz bukën, o Ilir.

Gjaku më kërceu në kokë. Doja t'i flisja rëndë Çal Çalibit. Para sysh më kalonte si në ekran fëmijëria ime e hidhur. Unë, hyzmeqari i Çalit, e kisha ngrënë bukën e Çalit vërtet.

— Si të duket buka ime? — Këto fjalë më tingëllonin gjithnjë në vesh. E tek po i jepja përgjegje, m'u kujtua një ditë...

«... Unë ruaja delet e Çalit. I lëshoja në kllotë që pa rënë dielli. Sa shumë vononte dielli që të dilte që prapa maleve të larta! Po edhe kur binte, unë i çoja delet hijeve që të mos i zinte vapa. Mërdhija shumë.

Vura delet përpara që t'i çoja te lisi i madh. Në hijen e tij do kalonim vapën. Delet kalonin duke dihatur nëpër atë re pluhuri që ngrinin tek shkonin duke shtyrë njëra-tjetër. Arave njerëzit mbillnin misrin. Te lisi pashë Çalin, që më priste me duar të ngulura në ije. Më shkuan të dridhura në trup, kur e pashë.

— Pse nuk i le dhe ca, more faqezi. Sot është më fresk se ditët e tjera e ti m'i sjell pa u ngjitur dielli tre litarë mbi mal?

Unë kundërshtova: — Sot është më nxeh të se ditët e tjera.

Kjo e detyroi Çalin të ngrinte dorën si sëpatë mbi kokën time. Më qëlloi. Ç'të bëja... Lotët më rridhnin e këmbët s'më bënин t'i shkoja pas, por ç'të bëja.

Ishte viti 1940.

Shtëpia e Çalit ishte ajo që është tani. Me avlli të rrethuar, me shtëpi, veç për burra e veç për gra. Brenda avllisë ishte një oborr i madh. Atje, kur u futëm në oborr, gjetëm të birin e Çalit. Ai, sa pa të atin dhe mua, filloj të përplaste këmbët në oborr e të qante duke uluritur: «Dua qershi, dua qershi, dua qershi...»

Ama dy gjëra më ranë në sy: djalit s'i dilnin lot, veç gérthiste sikur qante dhe mua nuk m'i ndante sytë.

— Merr një kaçile e shko shpejt mbushe me qershi e ma sill mua këtu — urdhëroi Çali.

Që larg, përmes gjetheve, dalloja qershítë e kuqe. Goja më lëshonte lëng. Atë ditë s'kisha vënë gjë në gojë. U ngjita në majë të një qershie. Degët e saj të vjetra qenë larguar nga trungu dhe, që të merrja qershi, duhej të hipja mbi to dy metra duke u rrezikuar.

Si mbusha kaçilen plot me qershi të pjekura, të èmbla si sheqeri dhe që u shkëlqente cipa e kuqe gjak, fillova të haja dhe të zbrisja degët njëko-hësisht nga frika se mos zemërohej Çali nga vonesa ime. Por papritur kaçilja më fluturoi. Unë zgjata të dy duart ta kapja, por u rrokullisa sa më një degë në tjetrën pas kaçiles, e u përplasa si trung pas tokës së fortë...

U ngrita duke fshirë lotët çalë-çalë, me kaçile të zbrazur dhe u nisa. Atë mbasdite nuk i lëshova delet. Isha i sëmurë. Po kisha uri të madhe. S'kisha vënë gjë në gojë. Askush s'kishte ndër mend të më luste, as të më jepte, ndaj mora një copë bukë misri të ftohtë. Kafshata e parë gati më mbyti, ndaj e shtyva si munda më ujë dhe pastaj ju afrova atij çeberrit ku mbanin gjizë. Mbusha grushtin.

Gjizë të tillë s'kisha ngrënë ndonjëherë, si nga shija, ashtu edhe nga pamja; ishte si gur lumi i bardhë. Sa më shijonte buka! Mora prapë nga ajo gjizë dhe hëngra, derisa u ngopa. Piva ujë të ftohtë dhe ngeli në kujtesën time buka e asaj dite.

Në mbrëmje u dha poterja në shtëpi.

— Kush tjetër përveç Ilirit? — dëgjova të zonjën e shtëpisë.

Çali m'u afrua i egërsuar, më zuri prej veshi e më pyeti me zë të lartë:

— Ke ngrënë bukë sot?

— Po.

— Po tjetër veç bukës?

— Edhe gjizë — thashë unë me drojtje.

— Gënjen — bërtiti ai dhe veshi im sa vinte e skuqej, por nuk këpuntej. Por unë kundërshtoja gjithnjë duke thënë se kisha marrë gjizë dhe asgjë tjetër, duke mallëkuar atë bukë të zezë të Çelibëve.

Kundërshtimi im e bëri të më thoshte: — Hajt më trego ku e more.

Unë i dhashë trupit përpara me rrëmbim, por shpejt bëra një hap prapa. Harrova se veshi im ende qëndronte i shtrënguar nga dora si darë e Çalit.

— Këtu e mora — tregova unë atë çeberrin prej druri pishe, që lëshonte erë të rëndë e nxinte nga të gjitha anët.

Çali nxori diçka nga çeberrri e unë përmes lotëve pashë që i zbardhët në dorë.

— Çfarë është këta? — më pyeti.

— Gjizë...

— Nuk është gjizë, more derr. Këta është dja-thë. E bleva në pazar si frëngu pulën e ti vjen e ha pa pyetur njeri.

Unë vërtet s'e njihja djathin...»

Ngrita sytë dhe pashë atë, Çalin, që më mësoi të dalloja gjizën nga djathi e në vesh më tingëlloi: «E, si të duket buka ime? E, si të duket buka ime!» Po unë i flisja me zë të qartë e pa u rrëmbyer. Ama nuk lashë pa ja thënë ato që duheshin për ta bindur e sqaruar...

Ai më shikoi me vërejtje sikur donte të m'i zbulonte ato që mendoja atë çast. Si u mendua ca, filloi të fliste me fjalë prekëse e me zë që i dridhej aq shumë, sa unë kuptova se aty do të shpërthenin lotët e Çalit:

— Kur ike prej meje, unë, për besë të zotit, qava. U mërzitëm i madh e i vogël. Po mua mbi të gjitha më ngeli merak që nuk të dhashë gjë tjetër veç atyre opingave e rrobave të shtatit. Shumë pak... Një palë opinga për ty, Ilir, që të kam marrë kërthi kur ngele jetim e që m'u pate ba si djalë. — Këtu zëri i tij u bë më prekës se asnjëherë e, vetëm si pu-shoi një çast, vazhdoi:

— Ku ta dija unë i varfri plak — përsëriti — se do të vinte një ditë e ti do të vish e të komandosh fshatin e mue Çal Çalibin të më ndash nga shoqëria? Na nuk do të rrojmë dyqind vjet. E sa të rrojmë, të jemi me shoqérinë në dasmë dhe në mort, në punë e në luftë, kudo...

Bisedoja me të dhe veten e shikoja si në ekran në verën e vitit 1942...

«... Një palë opinga e teshat e shtatit...»

Kur vinte vera, ndryshonte puna e bariut në shtëpinë e Çalibëve. Ndryshe nga në pranverë, tani delet duheshin kullotur lart në mal ku kishte kullotë të mirë e ujë të ftohtë.

Verës nuk mbërdhija, edhe pse qëndroja në brez e lart i zhveshur, Këmishën time gjithë arna e lija

sipër ca shkurreve në mëngjez dhe, kur këthehehesha në mbrëmje, po atje e gjeja. Askush s'e ngiste atë këmishën time mbi shkurre. Trupi më qe nxirë e lëkura më qe trashur. Leshrat më vareshin deri te supet e kushdo mund të më merrte për cucë.

Një natë, kur po i afroja delet te dera e oborrit, gjeta Çalin. Delet ecnin duke rendur si të sëmura. Barku u kishte dalë në të dy anët e shpinës si kacek. Unë i trembja, po ato s'donin të ecnin, veç qëndronin duke u përtypur.

Çali i pa delet ashtu të fryra dhe unë i pashë tek buzëqeshën pak mustaqet e tij të zeza.

I kalova përpara duke trembur delet. Aty, tek po shikonte delet, padashur i shkuani sytë te këmbët e mia. Lëkura e këmbëve në fillim më qe trashur e s'doja t'ja dija as për ferra e as për gurë, por tani ajo më qe plasaritur keq. Këmbët më qenë bërë plagë. S'më duronin as të ftohtët, as të ngrohët. Në mbrëmje, kur bija për të fjetur, shpeshherë s'më zinte gjumi. Ato më digjin e më përvëlonin.

Çali më premtoi se me të vajtur në pazar do të më blinte një palë opinga, po t'i kullosja delet ashtu. Ja, ato opingat që më përmend tani. U gjëzova pa masë për to. E pashë veten duke vrapiuar rrugëve, lëndinave, shpateve me opinga veshur. Fjeta i gjëzuar atë natë dhe të nesëermen i lëshova delet shpejt. Kalova kodrave duke vështruar mos gjeja ndonjë shok andej e t'i tregoja për opingat. Por atë ditë gjithë kohën unë mbeta vetëm me delet dhe me èndrrat e mijë në kokë.

Më kishte zënë gjumi.

Kur hapa sytë, dielli kishte ikur, èndrra ime kishte ikur... Delet kishin humbur.

Vrapova ahishtes me këmbë të gjakosura. Po s'pashë gjë. Ndalova disa herë. Më dukej sikur dëgjoja ato këmborë, vrapova përsëri e vrapova duke gulçuar, por delet nuk i gjeta.

Djersët më rridhnin e unë mallëkoja gjumin, djersët dhe veten time. Thashë se mos ishin futur në luginë. Vrapova atje. E kur u lodha së renduri poshtë e lart pyjeve, u ngjita në kodër. Atje qëndrova të çlodhesha. Qielli i kaltër qe mbushur plot me yje. Pas pak doli hëna, që u dha maleve me dritën e saj të zbetë, një pamje të mahnitshme. Grykat e luginat nxinin. Kënga e zogjve të natës kish-të filluar. Një fllad i lehtë frynte duke tundur fijet e gjata e të rralla të barit midis gurëve. Fshati mezi dukej që larg. Vetëm në oborrin e ustait tonë të varfër dukej dritë. E njihja atë zjarr. Ata nuk kishin oxhak në shtëpi. Dimrit ngroheshin pranë far-kës, verës në oborr pranë zjarrit... Sa herë shkoja tek ata...

Nga larg vinin të lehurat e qenve. Kisha kohë që s'më bëhej të dëgjoja as këmborët e deleve, as-zérin e Çalit.

Më vinte keq për opingat.

LITARI NË VALË

Dëshmorëve të Arvejës

Kjo ndodhi pak ditë përpëra se Shqipëria të fitonte lirinë.

Mbi Arvejë qëndronin re të zeza. Shiu ishte gati në të filluar. Vetëtimat çanin qiellin. Gryka e Drinit ushtonte. Faqet e maleve përballë duke-shin via-vija nga përrenjtë e mbushur plot me ujë. Fshati dukej si i shkretë. Rrugëve s'lëviste këmbë njeriu. Avdiu e Ismeti ngjitën me vrap bokën e u futën në malin e Arvejës. Drunjtë e lartë e të drejtë zinin me degët e tyre gjithë qiellin. Poshtë në tokën e lagur qe shtruar qilimi ngjyrë kafe i gjethethive të rëna. Tek shkelnin me gjethë, nën këmbët e tyre dëgjoheshin lëndët kur shtypeshin dhe degët e thata që thyheshin. Ata vraponin pa u ndaluar.

Atë ditë lumi i Valbonës dukej zhurmëmadh e i egërsuar. Valët ngjyrë kafe përkundeshin kulma kulma gjatë rrjedhjes, derisa përplaseshin fort pas shkëmbinjve, pastaj të zemëruara riktheheshin në formë harku duke lëshuar zhurmë e stërpikëla.

Mbi valët e egra të lumit ngrihej një urë e

kalbur. Nsa në sfond ngrihej fizionomia e errët e malit të Arvejës. Larg, por përballë urës, ishte mbërthyer kolona gjermano-balliste.

Kolona kishte kaluar Qafën e Kolçit. Ajo ishte një kolonë e gjatë, e zezë sa nxinte rrugët. Dhe ja tani ishte në breg të lumit. Ajo donte të kalonte lumin. Po si? Nga ta kalonte? Atë ditë lindi një pikëpyetje e madhe: A do të arrinte kolona gjermano-balliste të godiste në shpinë forcat partizane që luftonin atyre anëve e të masakronin fshatrat me radhë?

Nga shtëpitë e mbeturë me pleq, gra e fëmijë, dolën ca fshatarë që zunë pritat. Në mes të një lëndine Ismeti dhe Avdiu panë Canin e Rasimin. Ata u përshëndetën si partizanët me «Vdekje fashizmit!» e «Liri popullit!».

Ndërkaq pararoja gjermane kontrollon vendin. Valbona mbyt zhurmat e hapave të rënda.

Ismeti u hodhi një vështrim shokëve. Të gjithë e kishin ngulur vështrimin te kolona gjermane. «Kushedi ku do të jetë Lini tani?» tha ai me vete.

Linin e kishin nisur si korrier te partizanët. Ai do t'i lajmëronte ata patjetër. Ata e dinin se Lini do t'i lajmëronte.

Patrulla ndaloj para urës. Ajo vështroi urën me dyshim, pastaj ja nguli sytë faqes së malit. Çdo gjë u dukej e dyshimtë, e pasigurtë. Vetëm zhurma e lumit dëgjohej e ashpër.

Ushtari i parë shkeli mbi urë. Ajo filloj të luhatej. Ishte e ngushtë ajo urë mbi ato valë të egra. Ushtari ktheu kokën nga shokët. Pas tij u nis dhei dyti, i treti. Ura luhatej. Ata ecnin ngadalë larg

njëri-tjetrit. Ushtarët ecnin mbi urë duke shtrën-guar automatikët. Pas tyre vinte kolona e gjatë.

Midis zhurmës monotone të valëve të lumit u dëgjuan fare papritur krismat e pushkëve. Një ushtar nazist u përkul duke shtrënguar ijet me duar dhe ra midis valëve të lumit. Për disa minuta s'u duk më, por pastaj lumi i dha udhë. Përpara i printsë mbi valë helmeta e përmbysur me kryqin e thyer e pas ai trung i zi dhe ushtari i vrarë.

Kolona ndaloi, por pararoja u vu në lëvizje. Duhej të kalohej më çdo kusht ura.

Shihej qartë se gjermanët diç po pregetitnin me ngut.

U dëgjuan krismat e mortajave dhe plasja e predhave. Por ata qëndronin prapa shkëmbinjve pa ja ndarë sytë armikut. Lufta bëhej gjithnjë më e ashpër. Ndërkohë ushtarët gjermanë shkelën mbi urë.

Që prapa shkëmbinjve të shtënati u dendësuan. Plumbat e tyre i bënë të shtriheshin nazistët, të shtriheshin barkas atje midis urës së kalbur.

Koha u keqësua më tepër. Binte shi. Qielli nxinte. Mbi lumin e egërsuar ngriheshin avujt si re të murme, sikur donin të maskonin valët.

Ata edhe mund ta kalonin urën. Ishin shumë dhe fshatarët kishin fare pak fishekë.

Zgjidhja ishte e qartë, duhej shembur ura.

Nga pozicioni fshatarët nuk e kishin larg urën. Ismeti u zvarris derisa mendoi se granata mund ta shpartallonte.

Ura u këput. Mbi valët e egra notonin dërrasat e kalbura dhe ata që u ndodhën sipër tyre.

Të shtënati pushuan. Midis dy faqeve të malit një urë e këputur. Kolona kishte ndalur, por në krye të saj shpeshherë dëgjoheshin të shtëna.

— Shikoni te livadhi i mullirit — foli Ceni.

Ata kthyen kokat andej.

— Çfarë po bëjnë atje? — pyeti Rasimi.

— ...

Gjermanët po i afroheshin lumi.

— Atje s'kalojnë dot. E shikoni lumin.

— Edhe mund të kalojnë.

— Si do ta kalojnë se?

Një grup ushtarësh lëvizi drejt valëve. Të tjetër u zhdukën prapa gurëve duke zënë pozicione gjatë bregut. Ushtari i parë u fut në ujë. Duart i mbante mbi armën e tij. Uji i mbuloi gjunjët, brezin. Ai ecte...

— Po këta ku duan të kalojnë?

Ushtarit i dukeshin vetëm supet mbi ujë.

— Shpejtoni! Të shkojmë dhe ne atje. Këmbë nazisti s'do të lëmë të kalojë, derisa të vijnë partizanët.

— Ata mund të na zbulojnë.

— Të lëvizim gjatë përroit...

Ismeti e Avdiu ju afruan bregut të lumit duke kërcyer që prapa gurëve, dëllinjave. Dhe ndaluan papritur. Ushtari gjerman s'kishte arritur të kalonte as gjysmën e lumit kur e përfshinë valët. Në fillim u ngrit lart, pastaj nga bregu diçka e tërhoqi fort.

— Qenka i lidhur me litar!

— Po për besë.

Pastaj valët e mbuluan. Grupi i xhenierëve në breg u ngrit në këmbë dhe tërroqi me të shpejtë litarin që të shpëtonin një të mbytur.

— T'u qëllojmë, shokë.

— Jo. Mos u ngutni.

— Pse të mos u qëllojmë. Ata po mundohen të hedhin litarin në këtë anë. Dhe, po ta hedhin...

— Prisni. Ne pse jemi këtu?

Një oficer nazist u ngjit mbi breg dhe, si dha disa urdhëra shpejt e shpejt, u fsheh. Skuadra siç ishte lëvizi nga pesëdhjetë metra bregut deri atje ku lumi hapej në shtratin e tij. Të gjithë ushtarët kishin kapur litarin. Skuadra u fut në lumë. Ato rrinin larg njëri-tjetrit dhe lëviznin me radhë.

— Ti qëllojmë?

— Erdhën Ceni e Rasimi?

— Po. Ja ku jemi.

— Zini vendet. Të presim edhe pak.

— Të qëllojmë, ata janë shumë...

Po skuadra fare papritur u rikthyte në breg pa bërë as tridhjetë hapa në ujë.

— Pse u kthyen?

— S'kalojnë dot.

— Shikoni.

Mbi valët e egra të lumit notonin njëri pas tjetrit lisa të mëdhenj të shkultur me degë e rrënje nga moti i keq i atyre ditëve. Ushtarët, si u bindën se gjatë rrjedhjes së lumit nuk kishte lisa, pa u vonuar u futën përsëri në ujë. Herë-herë uji i mbulonte, por, duke ndihmuar njëri-tjetrin, ata i afroheshin bregut ngadalë përmes valëve. Pas linin

një litar të trashë, që, sa vinte, bëhej më i tendosur nga ushtari i fundit e deri atje tek ai shelgu ku ishte lidhur fort.

— Qfarë presim, t'i qëllojmë.

— Ata, po hodhën litarin... T'i qëllojmë, t'i vrasim ushtarët.

— Të parin unë

— Të dytin unë.

— Mos u ngutni.

— Si, more, mos u ngutni. Unë po ha duart me dhëmbë e ky na thotë prapë mos u ngutni. Nuk i sheh, ata po afrohen, po e kalojnë gjysmën e lumit. Atje uji fillon të jetë më i pakët. Matanë kanë gjithë ato forca që i mbështesin. Ata po presin me ankth të hidhet litari, të kalojnë...

— Të tre e vështruan shokun që fliste. Në kokë bluanin të njëjtin mendim. Po nuk flisnin. Gjermanët afroheshin drejt tyre.

— Të mos i qëllojmë ushtarët — tha njëri.

— Po kë? Oficerin?

— Jo.

Ata panë me habi shokun.

— Të qëllojmë litarin.

— Litarin?!

— Po.

— Ku e këpusim dot litarin! Nuk është urë.

— Këputet edhe litari.

— Ta qëllojmë?

— Ku ta qëllojmë?

Ushtarët nazistë përlesheshin me valët. Kishin bërë mjaft përpara. Dukej se do ta kalonin lumin me siguri.

— Ta qëllojmë në shelg. Atje është lidhur. Atje duhet «zgjidhur».

— Mirë thotë Ismeti — foli Avdiu. — Të qëllojmë të katër njëherësh, derisa ta këpusim litarin.

— Si thoni, shokë?

— Ta qëllojmë.

— Ta qëllojmë sa më shpejt.

Dhe morën shënim të katër në një pikë.

— Gati?

Nazistët kishin përpara valët e tërbuara, ku si dukej ishte pjesa më e thellë e lumit. Dy prej tyre tërhiqnin litarin për të ndihmuar shokët, që përlesheshin herë duke u mbetur në valë dhe herë duke nxjerrë kokën me gjysmë shpirti.

Matanë lumit dhjetëra sy, dhjetëra tyta e gryka zjarri të drejtuara këtej nga bregu tjetër. Në mes Valbona e egërsuar. Në bregun tjetër disa trima.

— Gati? — përsëriti i njëjti zë.

Dëgjohej vetëm zhurma e valëve.

— Zjarr!

Katër pushkë vollën zjarr njëherësh. Pastaj u përsëritën disa herë me radhë. Nga bregu tjetër shpërthyen breshëri automatikësh e mitralozash. Predhat që fërshëllenin mbi kokat e tyre në gurë atje pranë mund të krahasoheshin me pikat e shiut që binin e binin gjithnjë.

Po litari u këput dhe bashkë me ta dhe shpresat e armikut për të kaluar lumin.

— U këput litari — foli ai i gjëzuar dhe qëlloi kundër nazistëve.

— U këput litari. Qëlloni, o trima! — foli ai përsëri duke marrë shënim mitralierin nazist në majë të bregut matanë.

Mbi valët e egra të lumit dëgjoheshin me lemeri thirrjet e nazistëve që shtrëngonin duart mbi një litar të këputur që i çonte drejt vdekjes së llah-tarshme.

— U këput litari — foli i njëjti zë disa herë me radhë dhe qëllonte gjithnjë, por vonë u kujtua se midis zhurmës së dallgëve e krismave të armëve, midis asaj zallahie të vërtetë, askush s'po i përgjegjej.

Ktheu kokën duke hedhur një vështrim me ngut nga shokët dhe sytë i mbetën të ngrirë mbi njërin atje pranë tij. Ai kishte rënë i mbështetur mbi pushkën e tij; dukej sikur po e përqafonte atë pushkë. Ju afrua pranë dhe, kur i pa fytyrën të mbuluar nga gjaku, sytë ju errën. E shkundi nga supet, por përgjegje nuk mori, vetëm pushka e tij lëvizi pak pa e ndërruar drejtimin nga bregu tjetër i lumit. Ai shtrëngoi fort nofullat që t'i bënte ballë dhembjes, që ndjeu atë çast e nga goja lëshoi një fjalë:

— Vëlla!

— . . .

Heshti. Ju bë sikur dëgjoi zérin e tij: «T'i që-
llojmë nazistët. Ata s'do ta kalojnë lumin, veç në
kalofshin mbi trupat tonë. Këtë bombë e ruajta si
sytë e ballit për një ditë...»

Pastaj ju afrua shokut tjetër. Kujtoi se dëgjoi
atje midis breshërive këngën e tij të dashur:

...Përvend tonë jam tuj luftue...»

Zemra i rrihte aq shumë, sikur donte t'i shkul-te kraharorin, që i ulej e i ngrihej me forcë. E

vështroi me dhembje shokun dhe ju hodh në qafë. Trupi i tij ju duk i ngrohtë. E shkundi nga supet, i thirri në emër, i thirri «vëlla», por ai qëndronte me sy të hapur atje përpara tij, me sy të kaltër që ishin ngulur në bregun matanë, sikur donin ta përpinin armikun:

«Edhe me gurë do t'i vrashim, ju bë sikur dëgjoi zërin e tij, armikun do ta përzemë nga toka jonë. Atëhere edhe na do të mësojmë nëpër shkolla...»

Ai hodhi shikimin në bregun matanë dhe qëlloi përsëri. Ju kujtua Lini, shoku i tij. Ju kujtuan partizanët. «Ai do t'i ketë lajmëruar patjetër» mendoi me vete. Lini është djale trim...

Gjermanët po afroheshin drejt bregut. Ai qëlloi e qëlloi midis shokëve në zemër të shkëmbit. Qëlloi e qëlloi... Lumi të Valbonës sikur ju shtuan valët; zhurmat dhe grykat oshëtinë fuqishëm, por midis tyre u dëgjua një si jehonë këngë, një thirrje më e fuqishme se çdo krismë.

— Përpara, partizanë!

Përpara! Përpara!

Dhe jehona kaloi lumin, pushtoi bjeshkën, puthi e puthi tokën e dashur.

KUR KOLOVITESHIN TROFTAT NËN PISHTARË...

— *Novelë* —

Ishte...

Dhe mendimin e lashë përgjysmë.. M'u kujtua gjyshi im.

«Ishte koha e luftës së malësorëve kundër Maxhar Pashës», mu bë sikur dëgjova në veshë zërin e tij të njohur. U mata të lexoja, por ç'të lexoja veç asaj fjalës «Ishte» dhe dëshirës që më lindi në mendjen time.

Ndaj i shkrova së bashku frazën e lënë përgjysmë dhe, dëshirën time:

Ishte koha e... kandilit dhe e pishtarit, kur çdo ngastër toke e rrethuar me gjerdhe mbante vu-lën «imja»... E kjo fjalë pinte edhe ujët e kulluar të lumit...

— Sikur ta dije ti, o gjysh, se këto u plakën më shpejt se yt bir... Sikur ta dëgjoje zërin e nipi, tek tregonë për dashuritë tonë...»

* * *

Mes maleve, nëpër grykat, e thella e të ngushta, lumi, tek gjarpëronte i qetë, dukej si një vijë e kaltër mbi tokën e gurtë që merrte në gji ujërat e panumërtë. Kënga shtohej më tepër, dhe kërcente shkëmbinjve ku kataraktet si dushe të fuqishme, të kaltëra, të bardha dukeshin sikur ishin copëra të atyre peisazheve mahnitëse që vazhdonin faqeve të maleve, deri në kupëzën e qillit.

Kur rrjedha e lumi ishte e qetë, nga bregu mund të shikoje troftat tek notonin dy-tre metra thellë në ujin e kaltër plot ngjyra. Atyre u shkëlenin luspat e arta. Në vjeshtë, kur fillonin shirat, lumi e ndjente veten të shtrënguar në grykat e ngushta. Valët merrnin ngjyrën e zgjyrës e rrini brigjet e egërsuara. Në ditë të tilla ajo, trofta e shkathët, që u ngjitët me lehtësi ujrave, po të ndodhet jashtë strehës, është e pazonja t'u bëjë ballë valëve të murme... Pastaj, kur lumi qetësohet, zalleve vrapojnë fëmijët për të mbledhur peshkun e mytur!...

Kështu ndodh pranverave kur rrezet e diellit shkrijnë borën duke zbuluar faqe të tëra malesh dhe duke çliruar grykat nga ortitet. Ditët kalojnë, të bucura, të nxehta gjithnjë e më shumë dhe lumi gjithnjë e më tepër qetësohet e bëhet i kthjellët, i kaltër në atë ngjyrën e tij...

Sa del nga grykat e ngushta, lumi vazhdon shtruar rrjedhën nëpër lugina sikur do të çlodhet. Dhe zhurmat i duken të largëta si jehonë bjeshkësh. Uji i lumi gjithnjë zvogëlohet, se në të dy

anët e brigjeve e presin me gojë të hapur si guak dhe e përpijnë kanalet vaditëse, motopompat.

Jo rrallë, peshku «hutaq» merr rrugën e atyre kanaleve me nge deri atje mes misërishteve ku toka është e etur për një pikë uji e bujku pret me shatë në dorë duke dëgjuar gërhamën e njojur të tokës.

Anëve të lumit ngrihen në gjoks të maleve të larta kodra e lugina dhe fshatrat njëri pas tjetrit, ku shtëpitë fshihen një nga një e dy nga dy të vëmuara.

Në Rrasë shtëpitë ishin kulla dy dhe trekatëshe të mbuluara me dërrasa e me dritatë si frëngji aq të vogla, sa s'fusje dot as kokën në to. Fshati qe në një luginë midis dy maleve, prej nga zbrisnin përrrenj të rrëmbyer. Dimrit përtetj tyre s'i kalonin dot bagëtinë në kullotë. Atje fillonin pyje të tëra me gështenja... Pas çdo kodre në pyllin e gështenjave shiheshin ngastra toke të thurura fort me gardh me hunj të çarë lisi e të prehur në majë. Për gardhin e arës a për një copë dru në pyllin e tjetrit kishin ndodhur sa herë ngatërresa e vrasje.

Mëngjezeve djemtë në Rrasë ngriheshin herët hipnin mbi kuaj e mbi mushka e mblidheshin në një luginë, ku rruga ishte e sheshtë dhe e drejtë. Atje fillonin garat me kuaj, zënjet e lavdërimet për kalin më të mirë. Pastaj, ata i linin kuajt në kullotë e ktheheshin në shtëpi, ku i prisnin pleqtë duke matur diellin me litarë...

Vajzat ata as që i shikonin me sy, veç të gjithë ishin në gjendje të thoshin se Zarifja e Zyber Shkurtit i kishte të rralla shoqet në fshat. Edhe nga larg po ta shikonin, ata bëheshin hokatarë e

ngrinin zërin duke vrapuar lëndinave si kalorës të çmendur mbi kuaj të hazdisur.

Zarifja ecte kokulur, sikur gjithnjë përpara saj rrinte vetë i ati, Zyber Shkurti, po djemtë ishin në gjendje t'ja përshkruanin ato sytë e saj të bukur... Zyberi e mbante të mbyllur në kullën e tij të bijën dhe kishte urdhëruar të shoqen që t'i jepte «nga ato të shtëpisë» e të fillonte nga paja.

Nuk kalonte javë pa i trokitur në derë Zyber Shkurtit miq nga fshatrat më të largëta, por ai ende s'e kishte dhënë fjalën, ndaj priste e përcillte miq... Kjo i kishte rënë në sy fshatit dhe, kur e pyesnin se pse po e zvarriste aq shumë fejesën e së bijës, Zyberi përgjegjej në mënyrë lakonike: «S'i ka ardhë kysmeti».

* * *

Zyber Shkurti kishte ditë që punonte në pyll. Atje ai, pasi do ta shpyllëzonte, do të hapte një copë tokë, që vaditej me ujin e lumit dhe do të prodhonte ç'të mbillte. Deri tanë ai kishte shpyllëzuar një copë tokë ku lisat e prerë u ngjanin ahishteve pas borërave të mëdha. Zyberi priste dru, çante është hunj për të thurur arën e re, por lisat s'kishin të sosur, të kryqëzuar stiva-stiva.

— Punë të mbarë, Zyber!

Ai lktheu kokën me sépatë në duar.

— O, mirë se vjen e të mbarë paç, usta Aqifi.

— Paske bërë gjithë këtë punë.

— Bereqavers, por më mundon sépata.

— Do të ta rregulloj sëpatën, o Zyber, po kam pasë punë. Djalin e shtrova në spital.

— Jo, more? Po ç'pati? ë! Mos harro edhe atë llozin e derës se tashti m'u kujtua — ndërroi bisedë Zyberi.

— «Bajamet» më tha doktori pa i vënë veshin Zyberit për atë që e porositi.

Zyberi i zgjati cigaren Aqifit.

Të dy burrat u ulën mbi një lis të rrëzuar.

— Domethënë shkove në qytet — tha Zyberi.

— M'u desh me ndejtë disa ditë — tha Aqifi.

— Ja hoqën bajamet?

— Ma së fundi vendosën doktorët e ja hoqën. Të shtunën do të shkoj ta marr.

— Të shkuara qofshin. Po a dole atij qyteti?

— Besa po dhe më thanë se te ne do të vinte një ekip për ngritjen e kooperativës.

— Ku?

— Këtu në fshatin tonë.

— S'besoj, — tha Zyberi — s'e ke marrë vesh mirë.

— Jo. Këtë e di mirë.

— Çudi po më duket, o Aqif... Çudi... S'ka çka lyp kooperativa te ne, more. Ha pula gur. Ti je mirë, se ke zanatin, po mue me gjithë ata fëmijë... Tokë... — Zyberi dukej sikur fliste me vete.

— E di si asht puna, o Zyber. Mue më ka tregue djali.

— Ku di djali yt, o Aqif!

— Pse, more? Ai ka qenë tre vjet në kufi. Edhe atje mësë ishte, po kooperativën e kishin ngritur ejeta ishte më e mirë se këtu te ne.

Zyberi uli sytë fytyrëngrysur duke thithur atë çibukun e tij.

Malet i kishte mbuluar një tis i hollë mjegulle. Në qiel retë vraponin të nxituara. Pylli me lisa të gjatë dukej i zymtë e hijerëndë. Mbi gjethet e rëna shkëlqente një shtresë e hollë uji.

— Po a thue kur vjen ai...

— Ekipi do të thuesh?

— Po.

— Së shpejti e ke në fshat.

Zyberi heshti prapë, shikoi lisat e rrëzuar dhe atë copën e shpyllëzuar.

— Në Rrasë së pari, kjo po më çudit. Rrasë! Ha pula gur.

— Edhe në fshatrat e tjera. Bile më thanë se disa e kishin kërkue vetë.

— Kur, more, e kërkuen?

— Ja kishin kërkue shokut Enver, kur erdhi në festën e çlirimit të rrethit tonë vitin e kaluar.

— Mue më kanë thanë se në kooperativë futen njerëzit me dëshirë...

— Po — tha Aqifi. — Im bir më ka tregue shumë gjana për jetën e atyne kooperativave atje në kufi.

— Ti do të futesh?

— Po. Por ti mos i fut kaq mërsi vetes. Çdo gja do të bahet, po të pëlqeu. Po iki. Sëpatën do të ta rregulloj mirë.

Zyberi kishte ngrirë me sytë atje mbi lisat e prerë në atë copë të shpyllëzuar dhe mendohej. Ai pa kuptuar se si u nis me hapin e tij të rëndë. Që atë ditë s'e pa njeri të punonte për hapjen e tokës së re buzë lumit. Rruga ju duk e gjatë e gjunjët i këputeshin. Në kokë i zienin mendime të

ndryshme. Si do t'ja bënte ai, në rast se të gjitha rrugët do t'i mbylleshin dhe do të futej në kooperativë. Ku do ta çonte bagëtinë? Ta dorëzonte? Jo, këtë s'e bënte Zyber Shkurti. Po shpejt u pendua. Kushedi si bëhej puna. Ai duhej të largonte bagëtinë nga shtëpia. Sa për tokën, s'kishte ç'i bënte. Ama për ta shtuar s'do ta shtonte më Zyberi, sikur qameti të bëhej. Megjithatë ajo punë që kishëte bërë ja viente. Ai çdo ditë do të merrte nga një mushkë dru. Kështu do ta kalonte dimrin atë vit, ndofta edhe vitin e ardhshëm. Gjithë ata lisa të gjatë, të drejtë...

Zyberi që atë ditë u mbyll në shtëpi. E shoqja. Rabija, e dinte se, kur rrinte Zyberi në shtëpi, fillonin zënjet, rrahjet. Atij i pëlqente të dëgjohej zëri i tij duke u bërtitur të gjithëve me shkak e pa shkak. Që ato ditë ai filloi të mendonte si të shpëtonte pronën.

Dhe miza s'dëgjohej brenda atyre mureve. Rabija, që kur Zarifeja qe bërë katërmëbëdhjetë vjeç, lëshonte bagëtinë në kullotë.

Një mëngjez, kur Rabija do të çonte delet në kullotë, ai i tha:

- Afroi shpejt delet në mbramje.
- Pse, o burrë.
- Do t'i çojmë te Qerimi — tha ai me zë të ulët i frikësuar se mos e dëgjonte njeri.
- Pse?
- Vijnë për kooperativë. Do të na i marrin.
- Po edhe te Qerimi...
- Jo, he t'u thافتë goja, se atje tri shtëpi janë, e kooperativë s'ka për t'u ba kurrë atje...
- Mirë...

Dera e avllisë u hap dhe delet si të mpira fi-

lluan të shpérndaheshin rrugëve. Dielli qe ngritur lart mbi male.

Zyberi ngjiti shkallët e shtëpisë dhe shpejt do li përsëri në oborr. Në dorë mbante dy shufra he kuri të ndryshkura. I pa me kujdes dhe filloi ta drejtonte njërën me tunin e sépatës.

Ishin dy shigjeta, nga ato më të zgjedhurat, që Zyberi i përdorte për të vrarë peshk natën. Edhe ai e kishte në lumë një qoshe të tijën. Ai pellgu i tij përherë mbante peshk të shumtë dhe Zyberi kurrë s'që kthyer duarbosh. Pse ta linte t'ja merr nin të tjerët atë që e kishte «pronë» të tijën dhe si domos tani që kushedi... Motin tjetër e ka apo s'e ka...

Ditën flinte, natën shkonte në pellgun e tij për të zënë peshk. Zarifeja as në oborr nuk dilte dot nga i ati. Për atë kishin filluar ditët më të vështira të jetës.

Zyberi rrinte ulur në oborr me çibukun e tij në gojë. Mendonte veç për kooperativën. Kishte vendosur kështu që t'u thoshte atyre të ekipit: «Kam fëmijë shumë, s'i mbaj dot.» Sa për delet, do t'i niste atë natë për te Qerim Panja në Qafë të Kapro llit. Po ta shihte punën pisk sëpaku të shpëtonte delet...

«Atëhere s'më mbeti gjë tjetër veç t'u them: «Jo, jo, nuk futem dhe pikë».

— Po lopët? Ku t'i çoj lopët? — tha me vete.

— «Dorëzoni lopët, Zyber Shkurti — do më thonë ata të ekipit. — Ç'i ke gjithë këto.

Dy lopë e një mëshquerë, viçat.. Unë kam fëmijë shumë — do t'u them.

— Të mjafton një lopë, Zyber Shkurti».

Dhe ata do ikin pa një santim.

Zyberi dëgjoi një zhurmë atje në rrugë afër shtëpisë së tij. Dy veta po grindeshin. Ai shau nëpër dhëmbë dhe, duke mbyllur derën me zhurmë, ju kujtua llozi i ri që do t'i bënte usta Aqifi pér derën e avllisë së tij.

Shigjetat e ndryshkura Zyberi nuk mundi t'i rregullonte. Njérën prej tyre e këputi duke e goditur me sëpatë kur po e drejtonte. Ato ishin gjithë ndryshk, ndaj, sa herë godiste me forcë. këputeshin copëra hekuri të ndryshkura. Ai shau nëpër dhëmbë dhe mendoi që atë natë të mos shkonte pér të gjuajtur trofta. S'kishte me se t'i vriste... Po Zyber Shkurti nuk ju nda punës, edhe pse dielli po përqafonte malet në perëndim...

Mori një kosë, atë kosën më të re që kishte kositur barin sa herë dhe, si e shikoi mirë e mirë, mori daltë e çekiqë dhe filloj nga puna. «Do më dali një thikë e madhe dhe një e vogël. Me të parën do grij duhan. Po sot më duhet kjo tjetra, me majë të mprehtë, përsëriti. I çan barkun... E kujt s'ja çan? Po edhe troftës i bën derman». Zyberit i qeshi fytyra. Pjesa e këputur lëshoi atë krismën tingëlluese që ka kosa kur përplaset pas gurëve të fshehur në mes të barit. Zyberit ju kujtua kur u printe kosëtarëve në livadhet e tij. Ai e varte sahatin në trung të lisit, dhe, si bënin dy-tri xhiro rrotull livadhit, u thoshte atyre me siguri: «Sahati paska ecë më shpejt se na, o burra». Ai psherëtiu. Ndezi çibukun e tij dhe pastaj preu me kujdes një copë dru shelgu me sharë dhe e vendosi në vend të dorezës së thikës.

Nata u err e ftohtë e me shi. Në fshat, sa mleshin bagëtitë, shtroheshin rrëth sofrës dhe binin

për të fjetur shumë shpejt. Zyberit i vinte mirë kur fëmijët dilnin të heshtur nga dhoma ose i merrte Rabija para duarsh e i çonte në shtrat. Ai pinte duhan afër oxhakut dhe me asnjeri nuk fliste. E me gjithatë Zyberi e kishte në majë të gjuhës fjalën, po të bëhej ndonjë faj...

Kur mbeti vetëm me Rabijen, i tha me zë të vrazhdë.

— Thirre Zarifen këtu.

Rabija ngriti kokën dhe e vështroi sikur ta pyeste, por s'guxoi, se ndeshi vështrimin e Zyberit.

— Hajde me mue — e urdhëroi Zarifen dhe mori atë thikën e re në dorë.

Rabija e kuptoi dhe s'foli. Zarifja e ndoqi pas e heshtur.

Zyberi zbriti nëpër shkallët e ngushta si tunel që të çonin në ahurin e bagëtive. Mbante në dorë një pishtar. Era e rëndë e plehut dhe e ajrit të prishur të zinin frymën. Lopët këthenin kryet të trembura. Njëra prej tyre u ngrit në këmbë dhe zuri të pëlliste duke shikuar viçin. Zarifja shikonte mëshqerën e saj, Gojfilen. Sa e donte atë Gojfilen. I jepte me grusht bukë, i jepte kalli misri pasi i copëtonë nga frika mos e mbysnin. Dhe mëshqera qe rritur e shëndoshur. Pa dyshim kush e shikonte, ishte i bindur se ajo, Gojfilje, do të bëhej një lopë e zgjedhur. Kur pa Zarifen, u ngrit në këmbë dhe zgjati kokën drejt saj, por zinxhiri i fortë i lidhur në grazhd ja vau brirët, ndaj shkundi kokën.

— Zgjidhe — urdhëroi Zyberi me thikë në dorë.

— Çka do me ba, o babë? Gojfilen time!

— Shpejt po të thom! — kumboi frikshëm zëri i njeriut, që s'pyeste veç vetes së tij.

Zarifja filloi tē qante. Atje shpejt erdhi Rabija.

— Pusho, lum nana, nuk ka gja. — Pastaj ju kthye Zyberit: — Edhe ti, mor burrë, si mundesh me ja vu thikën kësaj farë mëshqere. Na kena gjithshka, çka na duhet mishi.

— Ate e di unë — tha Zyberi kur mbaroi së lidhuri mëshquerën nga tē katër këmbët me litar, pastaj térhoqi dy fije dhe Gojfilja u rrëzua duke u pérplasur. Zarifja iku me vrap shkallëve tē errëta pa pyetur se ç'thoshte i ati, mjافت tē mos ndodhej atje dhe tē dëgjonte zhurmën e thikës në qafën e Gojfiles së saj.

Rabija s'guxoi tē largohej. Ajo mbante në dorë pishtarin dhe ktheu kokën mënjanë, kur thika lëvizi disa herë në qafën e kafshës dhe gjaku kërcëu currila-currila duke stërpikur tallat e misrit tē hedhura mbarë e mbrapsht nëpër pleh. Zyberi nguli thikën në tokë.

* * *

Të nesëmen nga mesi i ditës Zyberi hapi fjalën në Rrasë se ujku i kishte plagosur një mëshquerë, më tē mirën, tul e dhjamë, dhe e kishte therur...

Kur filluan tē vinin fshatarët, Zyberi i priti në derë tē avllisë me atë kandarin e tij me boçe tē zezë, që peshonte me kile e më okë.

Mishi vërtet qe i shijshëm, ndaj kush pagoi dhe e hëngri, tha: «Di ujku ta zgjedhë kërmën.»

Kështu po rriddhnin ditët për Zyberin, që pris-
te të ngríhej kooperativa.

2.

Meti kishte plot tre vjet që punonte si krye-
sondist në sektorin e gjeologjisë. Ai çdo fund muaj-
ji vinte në shtëpi dhe rrinte katër ditë, por ndodh-
te që vinte dhe të dielave. Kishte raste kur ai muaj
të tëra nuk vinte në shtëpi. Kur kishin avari, ai
s'pyeste për ditë pushimi. Ishin brigadë pararojë.
Ata ja kishin gjetur «sekretin» sondës dhe rrallë-
herë, kur u ndodhnin, i evitonin në një kohë të
shkurtër.

Meti kurrë s'e ndante nga vetja një broshurë
mbi evitimin e avarive në sondat K-300.

Atë ditë, tek shkonte për në shtëpi, ai e shman-
gu rrugën dhe me hap të ngadaltë kaloi afér shtë-
pisë së Zyber Shkurtit. Çdo gjë atje e kishte mbu-
luar një heshtje e zymtë dhe as pa, as dëgjoi gjë.
Sa kaloi në rrugën e ngushtë të rrethuar me gardh
e ferra, vuri re nga larg shkollën. Ju kujtua kur
rrinte në një bangë me atë, Zarifen. Bashkë ngjye-
nin në një shishe boje, i jepnin njëri-tjetrit lapsat
e bojërave... ja këto kishin qenë marrëdhënjet e
tyre. Pastaj e kishte zënë vendin e tij në bangë
Kasëm Çeti. Zarifja do ta ndihmonte atë në mësi-
me. Kasëmit i kishte ardhur keq për këtë, se Me-
ti nga banga e parë s'do t'i thoshte dot gjysmë
fjale, as në provimet me shkrim s'do të kishte si t'i
jepte «fletushkën». Në krah të tij rrinte Feridja,
që e ngrinte dorën, po të lëvizte edhe majën e
veshit...

Meti qëndroi një copë herë atje në rrugën e ngushtë prapa pemëve me shpresë se Zarifja mund të dukej andej. Pastaj dëgjoi zërin e Zyberit në oborr. «C'm'u desh që erdha sot,» tha ai i mërzitur. Atëhere u nis drejt shtëpisë së vet duke menduar se atë ditë s'e kishte vënë re njeri duke pitor më kot në rrugën e ngushtë të rrethuar në të dy anët nga ferrat.

Po në mbrëmje babai nuk harroi t'i thoshte ca fjalë, që e lanë të habitur dhe që u bënë shkak të grindeshin.

— Lene djalin të pushojë i qetë dy ditë në shtëpi, more burrë — foli e éma.

— Mue më thanë sonte, më thanë sonte — përsëriti ai: — «Rueje djalin, o Sali, se për besë, po i ngatërrrove telat me Zyber Shkurtin, do të jetë keq». Zyberit sonte i erdhën miq.

Meti ngriti kokën.

— I kërkojnë Zarifen. Tek ai çdo javë vijnë dy-tri palë miq për t'i kërkuar çikën — vazhdoi i ati.

— Në qoftë se nuk do ajo, ata s'kanë si e fejognë — tha Meti. Unë, o babë, do ta marr Zarifen. Ne kemi biseduar me njëri-tjetrin.

Babai skërmiti dhëmbët nga inati.

— Në gjak do ta marrësh?

— Në gjak. Unë do ta marr.

— Por ama dije se në këtë shtëpi s'e fut — tha babai i nxehur.

— Mos u ngut, more burrë. Djalin e kemi tonin. Na këtë djalë kemi.

— Dhe të bëjmë krushqi me Zyber Shkurtin?! Bile as krushqi jo. Do të marrë të bijën në gjak. Sa të jem unë gjallë, jo, moj grue.

— Babë! — foli Meti. — Sot asht tjetër kohë.
Ti duhet ta dish...

— S'kam ç'të di unë — ja preu fjalën Saliu.
— Ne jo në fshat, por as në fis nuk jena martue
që shtrihet në njëzet fshatra e t'i kalon dymijë
shtëpitë. Ti dole më i zgjuari e më trimi e do me
marrë nusen në gjak e në derë të shtëpisë.

— Pse, o babë, po ç'e kemi Zyberin. Ne jemi
Gjokaj, ata Shkurti.

— I kemi në fis. Një jemi Gjokaj e Shkurti...

— Po fisi ynë éshtë Gjokaj, babë...

Plaku u nxi në fytyrë dhe, duke e parë me
inat të birin, vazhdoi:

— Unë s'di të merrem vesh me ty, o bir. Ti më
flet sikur s'je rritë në malësi. Na kemi zakonin to-
në. Brenda fisisit nuk martohemi. Gjokaj asht vllaz-
nia e jo fisi ynë. Ai përbledh gjithë vllaznitë...

— Ky zakon asht i keq — tha Meti.

— Nanën tandem unë e mora dymbëdhjetë orë
rrugë larg. E mësoka veza pulën sot.

— E si kena shpëtue pa u mbytë atë natë në
lumë, more bir — foli nëna. — Qe natë. Ishte rri-
tur lumi mal më mal...

— Pusho, moj plakë, me ato historitë e tua,
se na i ke tregue pesëqind herë, sikur s'kemi qenë
këtu na.

— Jo, more burrë, po i tregoj djalit. Edhe ti
nuk qe, kur kaluem lumin. Ti na prite në shtëpi...
se dhëndri... — tha ajo me drojtje.

— Veç asaj s'marr tjetër grue, o babë.

— Do të pendohesh, mbaji mend fjalët e pla-
kut ti, o Met — përfundoi Saliu duke u ngritur të
flinte para kohe si asnjë natë tjetër. Dhe doli nga
dhoma i ndjekur nga vështrimi i nënës dhe i Metit.

— Nanë, vërtet erdhën miq te Zyberi.

— Po, bir i nanës. Mos u ngatërrro kot atje. Cila çikë s'të mer ty, o Met?

— Nanë! Ne e duam njëri-tjetrin. I kemi dhënë fjalën njëri-tjetrit. A e di sa shumë duhem? Ajo, Zarifja, nuk është e keqe.

— Jo, bir, po në fshat, në fis...

— Ç'më duhet mue të marr një çikë, që s'e njoh, as e kam parë kurrë.

— Ti je i ri, o Met, por unë di se sa njerëz janë vra për shkak të grave.

— Jo, nanë, për shkak të grave, po për shkak të kanunit e të regjimeve, që i nxisin vrasjet. Sot Partia pushkën na e ka dhënë në dorë, por na e ka drejtar kundra armiqve tanë e bile edhe kundra zakoneve prapanike që edhe ato janë armiq për ne.

Nëna po e shikonte Metin duke i përkëdhelur kokën me dorë.

— Zyberi do t'i mbarojë shpejt punët edhe pse nuk do të hyjë në kooperativë.

— E di — tha Meti.

— Thonë se do të vijë një ekip.

— Në mos sot, do të vijë patjetër.

— Si do ta bëjmë ne?

Meti e shikoi buzagaz nanën.

— Të futemi, nanë, edhe ne, se ashtu thotë Partia. Deri sot, ç'ka thënë Partia, ne e kemi bërë edhe do të bëjnë sa të kemi jetën...

— Po na jemi pleq, more bir. S'punojnë krahët tonë...

— Jam unë, nënë, apo do më përzini nga shtëpia, siç tha baba — tna Meti duke bërë buzën në gaz. — Punoj unë, Zarifja...

— Jo, biri i nanës, po yt atë ashtu e ka, rrëmbehet, por ta dish se pendohet shpejt.

Nëna e përqafoi Metin dhe, si e puthi në ballë, doli nga dhoma duke menduar ato që do t'i thoshte të shoqit sa të shkonte atje. E gjeti të shtrirë në dhomën e errët. Mendohej Sala e pinte duhan në heshtje.

Nata ishte e errët. Frynte një erë e fortë, sa dukej sikur do të shkuleshin çatia dhe pemët rrëth shtëpisë. Vonë, pas mesit të natës, filloi të binte shi. Përtej murit, në dhomën tjetër, Meti dëgjon te zërin e babait e të nënës. Ata bisedonin. Xhami i njërsë nga dritat e krisur në mes e nga era që e shtynte, lëshonte një zhurmë monotone.

* * *

Shtatë burra njëri pas tjetrit u futën në dhomën e miqve. Në njëren qoshe rrinte një burrë me trup të bëshëm dhe me mustaqe të gjata. Haxhi e quanin, po i thërrisin Haxhë. Haxha kishte ardhur t'i kërkonte Zyberit të bijën. Në flokët e tij të zinj si pendë korbi e në mustaqet e gjata dukeshin thinjat e bardha. Kishte fytyrë të vrazhdë, dy sy të fshehur në gropëzat e thella, hundë të gjatë e mollenza të dala. Gjoksit i varej një qostek prej sermi që humbiste diku në një xhep poshtë xhaketës së tij prej kadifeje të zezë. Mbështillte duhan në atë kutinë prej bakfani dhe, si e vendoste : një një cigarishte të gjatë e të trashë me një sumbull qehlibari, e ndizte në zjarr pa përdorur mashën.

Haxha kishte mbledhur të gjithë miqtë e Zy-

berit, vëllanë e gruas, burrin e tezes, dajën e tij dhe tre baxhanakë. Ata rrinjin të heshtur duke shikuar herë Haxhën e herë Zyberin në qoshen tjetër tek u bënte kafet miqve.

Ademi, i vëllai i Rabijes, si njeri i shtëpisë që i jepej në punë të tilla, e hapi muhabetin i pari.

— Zyber Shkurti, kemi ardhë me këta burra me të kërkue çikën. Dhandrin e kena me vete, se kështu duhet sot. Çika jote është mbesa ime. Edhe unë kam dhembje në të. Mos me qenë burri i mirë, shtëpia e mirë, edhe unë kurrë s'do t'isha dakkord. Haxha le të flasë vetë, edhe ti, Zyber, edhe ju, o burra e na po vendosim si të jetë ma mirë. Unë s'kam çka themi tjetër, kur ju jeni të gjithë të shtëpisë e mendoni njëlljo si unë.

Haxha, duke shikuar Ademin, foli:

— Unë s'kam ç'them. Ju më njihni. Ju jeni miqtë e Zyberit, veç një gjë desha të thosha, se një rob unë e kisha gjetë kudo, por, mue më duhet një mik shpie, që të jetë burrë, se bija e tij s'ka ku shkon pa qenë edhe vajzë, edhe grue, edhe plakë e mirë...

Burrat pohuan me kokë.

— Unë po dal të takoj pak motrën — tha Ademi duke u ngritur në këmbë

Rabija në dhomën tjetër po preqatiste darkën për miqtë. Rreth tepensive të shtruara rrinjin ulur fëmijët. Ademi i shkoi me radhë, pastaj pyeti i habitur:

— Ku është Zarifja, motër?

— Në dhomën tjetër, vëlla. Shko e thirre — ju drejtua ajo një çunaku dhjetë vjeç.

Po Zarifja nuk erdhi.

Rabija shkoi menjëherë disi e nxehur dhe,

duke e mbajtur Zarifen për krahu, u kthye në dhomë.

Ademi, duke i buzëqeshur, i tha:

— Sa shumë qenke mërzitë për dajën, moj Zarife. Unë vij këtu e ti nuk pranon ta takosh dajën. Zarifja nuk i dha dorën. Nga sytë i rriddhnin lotët.

— Është e mërzitur Zarifja, o Adem.

— Sikur ta njihet siç e njoh unë, kjo nuk mërzitet, po gëzohet.

— Është e re, i vjen marre.

— Po, po, ashtu, është e re...

Zarifja dëgjonte në heshtje.

— Po ti, o motër, — ju drejtua Rabijes — a do të bësh si thotë yt vëlla edhe këtë herë?

Rabija, duke shikuar të bijën, foli:

— S'po di ç'thotë im shoq se mua s'më pyet njeri këtu.

— Sidoqoftë, të pyet, s'të pyet, fjala jote ka vendin e vet. Kur t'i mblidhemi të gjithë Zyberit, s'ka ç'bën, do ta japë fjalën.

Zarifja pshërëtiu thellë, lotët i rriddhnin e trupi i dridhej.

— Është i mirë. Shtëpi e mirë, shtëpi e madhe. Tridhjetë e pesë rob në shtëpi. Kanë gjithë atë pasuri, tokë e bagëti...

— Tash po vjen kooperativa, more vëlla.

— Çfarë kooperative, na jemi në mal, janë fjalë ato që i thonë ata që s'kanë vec një rrip toke nën shpi... Të jetë fushë, edhe ne jemi dakord...

— Unë kam pasë frikë, më të thanë të drejtën, o vëlla. Kemi fëmijë shumë. Na të dy po plakemi tashti.

— E po bash tashti që po plakeni, ju duhet një

mik i fortë me pasuri, me tokë, me meshkuj, që t'ju ndihmojë.

— Jo, bre välla, se me miell hua nuk jetohet. Çdo dhandër, kur të merr çikën, të kthen shpinën.

— Kjo, si të jetë njeriu, po Haxha është burrë i pjekur. — Pastaj ju afrua te veshi dhe i pëshpëriti:

— Shtatëmijë të reja i ka me vete. Ju kërkon ni sa t'jua marrë mendja — dhe u ngrit pa marrë përgjegje nga e motra, dhe pa ua vënë veshin loteve të Zarifës.

Sa doli në korridorin e errët, u ndesh ballë përballë me Zyberin. Ata diç pëshpëritën me njëritjetrin dhe Ademit i qeshi fytyra, sapo hapi derën e miqve.

Zyberit i kishte pëlqyer Haxha si burrë i matur dhe me mend, pastaj shtëpi e madhe, me tokë, me pasuri. Atij ende i tingëllonin në vesh fjalët që i kishte thënë usta Aqifi për ngritjen e kooperativës, por zëri i Haxhës i vendosur ja kishte lagnaruar frikën, e kishte bërë të gjëzohej në shpirt:

— As më të voglën frikë të mos kesh, o Zyber. Këtu te na s'është e mundur të ngrihet koooperativa. Kam një mikun tim, punon në financë, në komitetin ekzekutiv. Ma mirë se ai s'e di njeri. Shikon rrugën e lekut ai, ku do të shkojë e nga do të merret.

Vonë, kur gjelat e parë filluan të këndonin, u vendos që pas tetë ditëve, të enjten, në mbrëmje, të bëhej fejesa në shtëpinë e Zyberit. Miqve u erdhi keq që nuk e përfunduan që atë natë fejesën, po Haxha fytyrëngrysur mendonte. A do t'i mblidhët dot deri ditën e enjte të dhjetëmijë lekët

që duhet t'i numëronte në tabakanë e Zyber Shkurtit pasi të pinte kafenë e Zyberi t'i thoshte: «Për hajër cikën»?

3.

Malet në horizont dukeshin të qeshura nga dielli, që shkëlgente në qiellin e kaltër. Meti e cte nëpër atë rrugën e ngushtë të rrrethuar me gardh e ferra në të dy anët. Ishte rrugë e vjetër dhe nga uji qe gjerryer shumë. Ajo ngjante si një tunel i ngushtë. Të zihej fryma nga era e rëndë e plehrave të bagëtive tanë që dielli ngrohte tokën.

Po mendonte për Zarifen, për miqtë, për Zyber Shkurtin, kur pa tek vinte drejt tij Kasëm Çeti. Po bëhej gati t'i fliste, por fytyra e Kasëmit e vrenjtur, sytë të ulur, sikur të kërkonte diçka atje përpara këmbëve të tij, e bënë të stepej. Kasëmi i kaloi pranë pa e shikuar, i heshtur hundë e buzë.

Meti ktheu kokën dhe i foli:

— Si je, o Kasëm Çeti, pse nuk flet?
— Nuk më do qejfi të flas, as të ta shoh bojn. Shko në punën tënde.

Meti u çudit.

Ai bëri dy-tre hapa drejt tij që të merreshin vesh, po Kasëmi largohej pa ua vënë veshin fjalëve të tij, derisa u zhduk pas një bregu.

Fjalët e Kasëmit e çuditën. «Diçka do të ketë ai, mendoi Meti. T'i ketë thënë ndonjë fjalë ndonjeri sa për të na futur në grindje?» Duke mënduar për Kasëmin, ai kishte arritur përpara shtëpisë së Zyberit ku ngadalësoi hapin. Përpara tij e

njëjtë pamje e zymtë. Shtëpia e rrethuar me avlli dhe pemë. Dyert të mbyllura si gjithnjë. Ai vazhdoi më tej rrugën drejt kopshtit me kumbulla. Ndaloj papritmas në mes të rrugës. Ju bë sikur dëgjoi më tepër fëshfërimën e gjetheve se sa të një njeriu, që tha: «Met».

Ai mundohej të dallonte mirë atë zë.

— Met! — dëgjoi përsëri.

— Zarife! — thirri ai pa ditur se nga vinte ai zë aq i dashur për të.

Në kornizën e drı̄tares së hapur ai pa fytyrën e Zarifës. Dy gropëza i dukeshin në cepat e buzëve. Ballin ja ndante përgjysmë një tufë flokësh dredha-dredha.

Meti deshte ta pyeste se çfarë u kishte thënë Zyberi miqve, por u pendua nga frika se mos do ta shuanë me ato fjalë buzëqeshjen e saj.

— Met, mos ik...

Meti buzëqeshi dhe, sikur të mos i dëgjonte mirë fjalët e saj, ju përgjegj:

— Nesër do të shkoj, Zarife.

— Mos ik, Met. Pesë ditë... dhe uli kokën.

Meti po bëhej gati ta pyeste dhe t'i thoshte shumë gjëra, kur papritmas ai pa në vend të fytyrës së qeshur të Zarifës, kornizën e drı̄tares që nxinte.

— Zarife! — thirri ai.

Po në vend të përgjegjes dëgjoi prapa krahëve një zë fyes:

— I poshtë!

Kur ktheu kokën, që prapa ferrave shkau si hije dikush. Mendja i shkoi te Zyberi. «Le të jetë, tha me vete, s'ka q'më bën.» I bëhej sikur ende

dëgjonte në veshë atë fjalë fyese. Si i hodhi një vështrim kornizës së dritares, që nxinte, bëri rrugën poshtë, ku priste mbi një breg Kasëm Çeti. Trupi i tij i shkurtër, lëkura kaleshe, e zezë, koka tullace e rrjepur para kohe, ku i kryqëzoheshin ca qime të rralla floku, sytë e tij si të maçokut, e bënin aq qesharak, sa Meti aty për aty ndërrroi mendje, se qe preqatitur t'i jepte një mësim të mirë atij Kasëm Çetit. Buzëqeshi lehtë dhe vazhdoi rrugën.

— I poshtër!

Metit i kërceu damari në kokë dhe me një kërcim u ndodh përballë tij duke e shkundur me të dyja duart nga gjoksi.

Kasëmi ishte zverdhur në fytyrë, por goja s'i pushonte...

Meti e kuptoi se Kasëmi i kishte vënë synë Zarifes, ndaj endej si hije ditë e natë asaj rruge. Ai do t'i kishte thënë edhe babës së tij.

Në mbrëmje gjithë fshati e mori vesh zënjen e tyre, bile edhe shkakun. Filluan fjalët nëpër fshat:

— Zyberi fejoi vajzën.

— Zyberit ja mori Met Gjoka vajzën. Turp!

— Turp më të madh nuk ka të martohet në fshat, në fisin e tij...

— Zyberi do ta vrasë.

— Ai që i shkon në shpi apo flet me Sali Gjokën e të birin, është si ata...

E këto fjalë i dëgjoi Rabija, që i vuri së bijës edhe një mur përpara, duke u dridhur nga frika se mos dëgjonte vetë Zyber Shkurti. Ai çdo natë shkonte në lumë për të zënë trojtë bashkë me Kasëm Çetin.

* * *

Atje fillonin e lartësoheshin malet. Në lugine
qe ngritur një si qytet i vogël me pesë barraka
prej druri, të cilat natën shkëlqenin nga dritat
elektrike. Punëtorët sondistë atje hanin, flinin, pu-
nonin...

Meti, tek njitej drejt kodrës ku ishte sonda, pa
nga larg ato dritat e vendosura mbi kullën e lartë,
të cilat ju dukën si yje të shndritshme në sfondin
e qiellit. Zhurma e motorëve e mbyste heshtjen e
natës. Gjergjin, sekretarin e organizatës bazë të
partisë, e gjeti duke biseduar me punëtorët. Ishte
turni i dytë. Simoni ja dorëzonte Metit në orën
njëmbëdhjetë.

— Po ti, o Met, ç'deshe në këtë orë? Ti ke
turnin e tretë, duhet të flije pak, apo jo?!

— Desha të bisedoja me ju për një problem
timin — tha Meti.

Gjergjit i shkoi mendja te shtëpia e Metit, pa-
si ai atë ditë qe kthyer.

— Të bisedojmë këtu, si thua, Met?

Ata qëndruan disa metra larg sondës. Zhur-
mat e motorit i detyronin të flisnin me zë të lartë.

Meti ja tregoi të gjitha Gjergjit, ashtu siç ki-
shin rrjedhur ngjarjet deri atë ditë.

— Bisedove me njeri në fshat?

— Jo.

— Shumë keq. Atje ka organizatë partie, ka
sekretar, ti duhet t'ua thoshe.

— Sekretari i organizatës është mik i Zyberit.

— Aq më mirë. Ai si sekretar do ta ketë më
lehtë ta bindë Zyberin.

— Po Zarifen tënde e kishte pyetur njeri, atë natë?

— Jo. Atë e ruan gjithë ditën Zyberi dhe s'e lë të dalë në prak të derës.

— Pse, nuk punon Zyberi?

— Jo. Që kur dëgjoi për ngritjen e kooperativës, ai e la punën që kishte filluar për të hapur një tokë në pyll. Do t'i fshihte edhe bagëtitë te një farë Qerim Panja në qafë të Kaprollit...

— Kush t'i tha këto të gjitha?

— Zarifja.

— E shikon, o Met, si janë punët tonë. Ai që cënon dashurinë tënde, ka cënuar edhe timen e të atij tjetrit, ka cënuar vijën e partisë në radhë të parë. Ai njeri duhet ndihmuar sa nuk është vonë.

Metit i vinte keq që pikërisht ai, i ati i Zarifes, të ishte i tillë.

— Atëhere duhet mohuar edhe e bija...

— Jo. Ai është njeriu ynë, por është mbartës i mbeturinave të së kaluarës. Ai duhet ndihmuar që të mos bjerë në faje të tjera. Kjo është detyra jonne. Po ta shpëtojmë atë nga gabimet, Zarifen e merr ti që e dashuron.

— O shoku Gjergj — u dëgjua një zë në mes të zhurmave të motorit.

— Urdhëro, Simon.

— E rregullova.

— Të lumshin duart!

— Vetëm kaq?

— E çfarë tjeter, o Simon.

— Ne jemi në mbarim të turnit, cigaret...

— Oh, më falni, harrova fare. Mbaje fare, Simon, se unë tani do shkoj në dhomë, kam cigare.

— Jo, jo, atje kam edhe unë.

Simoni erdhi duke qeshur. Në duar e në rrøba.
kishte njolla grasoje e vajrash.

Ai ndezi cigaren dhe iku me vrap.

— Ti bëre mirë që m'i the të gjitha, o Met.
Unë do të bisedoj edhe me shokët dhe ne të gjithë
do të të ndihmojmë. Do të shkojmë edhe në fshat.
Ne tani nuk kemi vetëm këtë, por kemi kooperati-
vën bujqësore ku duhet të ndihmojmë e të japim
shembullin, pastaj dhe Zarifen tënde, o Met — tha
Gjergji duke i rënë krahëve dhe duke qeshur vijoi:

— Tani shko e fli ndonjë orë të paktën, se do
të marrësh turnin. Apo s'të vjen për gjumë?

Meti qeshi.

Pastaj të dy njëri pas tjetrit u futën në barra-
kë, ku biseduan gjatë.

* * *

Të nesërmen Meti e dorëzoi turnin dhe, duke
zbritur kodrës me sy të buhavitur, i hapej goja
për gjumë. Edhe barrakat ju dukën si në mjegull,
sado që dielli shkëlqente. Padashur treti shikimin
në horizont, ku bënин ballë malet e larta.

Në faqet e zhveshura të atyre maleve ma-
dhëشتore e hijerënda, Meti dalloj si breza të gjel-
bër rudinat, ndërsa lart, majat e thepisura trete-
shin në kaltërsinë e qellit.

Nga mali frynte një fllad i lehtë dhe i freskët.
Dikush këndonte:

«Moj e mira n'at rudinë...»

Metit ju kujtua Zarifja. U dha këmbëve. Ajo ruante delet në bjeshkë. Mbase e takonte ashtu paritmas... I bëhej se pas çdo bregu e qafe do ta gjente tufën e deleve të saj dhe atë duke thurur një kunorë me lule bjeshke ngjyrë rozë të mbyllur...

Po shpejt mësoi se Zyber Shkurti e kishte dërguar të bijën në shtëpi. I kishte thënë Rabijes: «Po e çoj çikën te shpia, sa të na harbohet rudinave».

Atë natë Meti fjeti te gjeologët që bënin kërkime. Inxhinierja, një vajzë e shkathtë me flokë të verdhë e sy të shkruar, fliste dhe Meti ëndërronte kur do t'ua prishte qetësinë atyre maleve hijerënda e madhështore me zhurmën e motorëve e sondave të tij. Atë natë dëgjoi nga goja e inxhinières të flitej për baza paleontologjike. Në fillim s'i kuptoi, por pastaj, si mori shpjegime mbi moshën e shtresave të tokës, mbi thellësitë e kromit, bakrit, baoksideve, i mbeti në kujtesë për gjithë jetën.

Ai mendonte për sondën e tij.

Hyri në dhomë, ku s'gjeti njeri. U hodhi një vështrim krevateve të rregulluara keq. Në tavolinë një tavëll plot me bishta cigaresh dhe rrëth saj disa gazeta të vjetra e një revistë e shkaravavit.

Ai hoqi çizmet dhe kërceu në shtratin e tij ashtu siç ishte. Shpejt e zuri gjumi dhe filloj të pëshpériste ca fjalë pa kuptim. Po kalonte caste të vështira. Ai s'gjente qetësi, ndaj rrotullohej sa në një krah në tjetrin, pastaj përmbysej mbi shrat... Ju bë sikur po shihte Zarifen. Ajo vrapiqte përmes një mali, ku rruga humbiste monopateve të thepisura. Shamia i kishte rënë nga koka e flokët e saj dredha-dredha ja shtynte era prapa. Ajo vrapiqte e vrapiqte e mezi mbushej me frymë. Kur

Ikthente kokën pas, shikonte e frikësuar ata që e ndiqnin... Kasëm Çeti qe afruar më shumë, po edhe ai herë pas here shikonte i trembur prapa, se mos e kapnin Haxha, Zyberi dhe pesë burra të tjerë që ngulçonin pas tyre... Kasëmi mundohej ta kapte dhe ta fshihte diku ndanë pyllit e të zhdukej bashkë me atë, Zarifen e bukur, së cilës po i merrej fryma nga të rendurit. Ajo sikur e shikonte Metin diku aty afër që e priste me krahët hapur. Kasëmi përsë-riste e përsëriste atë sharjen fye...

Më në fund Zarifja u këput dhe ra me duar të kryqëzuara në gjoks sikur donte ende të mbrohej... Kasëmi, Haxha e Zyberi e rrëthuan duke dihatur. Haxha zgjati krahët e fuqishëm, e ngriti në ajër sikur ngrinte një tufë lule. Kasëmi kafshonte buzët e shante, Zyberi numëronte lekët... Buzëqesh-te Zyberi, ndërsa Zarifja mundohej të shkëpuesej më kot...

Haxha largohej gjithnjë me Zarifen në duar.

— Zarife! — klithi Meti dhe me një kërcim u ndodh në këmbë ashtu i përgjumur përparrë shtretërve të boshatisur të shokëve.

Ai fërkoi sytë dhe kur, s'pa njeri në dhomë, u gëzua pér herë të parë që s'ishin shokët pranë ta dëgjonin e ta shihnin ashtu...

Si doli jashtë nga barraka, ju duk sikur sundonte një qetësi e mërzitshme ndaj hodhi vështrimin rrëth e rrotull pa ditur nga të shkonte.

Nga maja e kodrës sonda e thërriste me zhurmën e saj të fuqishme.

Filloi të ngjitej lart.

Kishte kohë që po trokiste me forcë në derën e mbyllur të avllisë, po brenda atyre mureve dukej sikur s'kishte këmbë njeriu. Sundonte një hesh-tje e zyntë, sa zëri i usta Aqifit dëgjohej larg në fshat:

— O Zyber!

— ...

— O Zyber Shkurti!

Qeni lehu në haurin e bagëtive dhe në oborr u dëgjuan hapat e rëndë të Zyberit. Ai kishte fjetur që në mëngjez, ndaj sytë i qenë skuqur e enjtur. Kur e pa Aqifin, i foli me atë zërin e çjerrë:

— Më kishte zanë një gjumë i rëndë për besë e goja helm m'u paska ba.

— Qe ku të solla edhe sëpatën, edhe llozin, edhe shtizat — tha usta Aqifi.

Zyberi kapi llozin, ja mati derës dhe, si tha nga dy fjalë me zë të ulët, i mori Aqifit shtizat. I vështroi mirë e mirë duke vendosur gishtin tregonjës në majë të njërsë shigjetë dhe tha:

— Sikur t'i kiske mprehur edhe pak... Po më duken të trasha në majë.

— Unë kështu i kam bërë përherë, o Zyber, dhe të gjithë ma kanë lavdëruar punën... Ja edhe sëpatën, të kalitur për merak e ke. I kam dhënë ujë siq e ke qejf ti, e besoj se do të mbetesh i kë-naqur.

Zyberi i hodhi sytë në tehun e sëpatës dhe, duke e flakur në një qoshe, tha:

— Nuk më duhet kjo, jo. Ara e Zyberit mbeti pyll, dhe pyll të rrijë...

Aqifi e kuptoi dhe po bëhej gati ta pyeste se ç'e pengonte që të shpyllëzonte e të hapte një copë tokë të mirë, kur Zyberi ja priti:

— Sa të bën haku i punës, o Aqif?

— Kollaj është, o Zyber. I kam ulë çmimet tani që do të futemi në kooperativë... — dhe qeshi. Zyberi e shikoi me inat.

— Gëzohu, o Aqif, se ti je rritë si vezë e qyqes ndër ne.

Usta Aqifi u nxi më tepër në fytyrë nga ato fjalë të rënda. I inatosur foli:

— Pse, o Zyber, si vezë qyqeje. A nuk e nxora unë kafshatën me djersën time a? Po ti, more, kur më ke ushqyer mua apo fëmijët që më paske ditur vezë qyqeje?

— A të erdhi keq a? — tha duke zbuluar dhëmbët e rrallë Zyberi.

— E si të mos më vijë keq, kur ti më thua përnjë gjë që nuk e kam. A nuk është kështu? Unë punoja e haja. Kur s'kisha punë, s'kisha për të ngrënë! Tani që do ngrihet kooperativa, do të ketë punë për mua çdo ditë, edhe gruaja edhe fëmijët do të punojnë.

— Unë nuk hyj në kooperativë, se s'kam krahë pune.

— Pse? Je ti, plaka edhe vajza. Rabija nuk është më e vjetër se gruaja ime. Mos harro, vajzën e ke të rritur.

— Vajzën do ta fejoj këtë javë. Ajo do të martohet.

— E di ç'më tha djali? Atje në kufi, në atë fshat martoheshin vetë djali, vetë vajza.

Zyberi e shikoi me inat dhe, duke zgurdulluar sytë, i foli:

— Atë fjalë shko e thueja sojit tand e jo mue, more vesh. Më thuej sa të ban haku i punës?

— As që dua ta shoh me sy atë që më jep ti — ja përplasi në fytyrë usta Aqifi.

Zyberi e shikoi tek largohej rrugës me të shpejtë usta Aqifin dhe mbylli derën e avllisë. Ai filloj të përgatitej si çdo mbrëmje për të shkuar në lumë pér të zënë peshk.

Dielli ishte në të perënduar.

*

* * *

Ishte koha kur peshku mashkull bënte ato shëtitjet e tij nga pellgu në pellg ku troftat kishin vezët e tyre... Syri i stërvitur i peshkatarit e dallonte lehtë peshkun mashkull, jo vetëm pse ishte më i madh se të tjerët, por ai kishte dhe të tjera shenja: në luspa, në lëvizjet e tij mbi vezë aty në pellgun e qetë ku koloviteshin troftat. Peshku mashkull dallohej lehtë sidomos natën kur i afro-nin pishtarët mbi sipërsaqe, se drita e tyre i ndillte peshqit dy-tri pëllëmbë nën ujë. Dhe shigjeta ngulej gjithnjë mbi trupin e peshkut mashkull, ndryshe, po të vrisje troftat, natën tjetër s'kishe ç'të gjuaje, se në pellg s'kishin pse të vinin peshqit meshkuj...

Zyberi doli i trullo sur nga dhoma. Qe zënë me Rabijen. Fëmijët e shikonin të trembur. Zarifja rrinte kokulur pa e vështruar të atin në sy. Si doli në oborr, i hoqi qenit zinxhirin nga qafa dhe e

mbylli shpejt e shpejt derën që të mbetej brenda avllisë.

Zuri të ecte me hap të nxituar, se kishte frikë mos ja kishte zënë vendin njeri meqë ishte vonuar.

Ishte natë e errët. Net të tilla janë netët më të bukura për këtë lloj peshkimi. Nga maja e kodrës Zyberi dalloi vetëm një pishtar.

— Kasemi — tha. Ai e dinte mirë se të kujt ishin pellgjet e lumit. Kasëm Çeti shkonte çdo natë për të vrarë peshq me shigjetë. Lumi ishte i qetë dhe i kulluar. Kjo e gëzonte Zyberin. E kishte lehtë të shikonte peshkun. Megjithëse syri i tij ishte i stërvitur, tanë në atë moshë e kishte vështirë të dallonte peshkun mashkull dhe femër. Për këtë Zyberi as që bëhej merak fare. Me t'i parë troftat nën dritën e pishtarit, fap u ngulte shigjetën e tij të mprehtë dhe qeshte i gëzuar kur trofta e shkuar në tehun e hollë tundej e gjakosur në duart e tij. «Në je troftë, mashkull apo femër, thoshte duke e futur në torbë, hyrë këtu e mos bëj naze».

Midis gjithë pellgjeve, ku koloviteshin troftat, ai i Zyberit kishte më pak. Ai shkonte çdo natë. Dhe do të shkonte derisa të bindej se në pellgun e tij s'kishte lënë gjë që t'ja rrëmbenin të tjerët.

Ai kaloi monopatet e ngushta, ku i njihte edhe këmba çdo shkëmb e gur. Pastaj, duke kafshuar buzën, u hodh mbi një gur të gjatë që futej si gjuhë duke e ndarë pellgun përgjysmë.

Afroi pishtarin dhe priti një copë herë të gjatë dhe syri s'i zuri asnjë peshk. Ju kujtua usta Aqifi.

«S'do më shkojë mbarë sonte, ai firauni... do më ketë mallëkuar gjahun».

Dhe priti përsëri më kot.

Si njeri që besonte në fatin, ai foli me vete: «Gjynah, dreqi e mori atë usta Aqifin! Ka shumë fëmijë. Është i varfër. I kishte pantallonat të grisura. Do t'i dërgoj nesër që në mëngjez diçka për punën që më bëri usta Aqifi... po, do t'i dërgoj» përsëriti ai.

Dhe pas këtyre fjalëve hapi sytë më tepër duke shpresuar se peshqit do të afroheshin patjetër.

Në quell dukeshin ca yje të rralla. Nga gryka e lumi vinte një erë e ftotë. Zyberi qe kopsitur mirë e mirë, megjithatë nëpër trup i shkonin të dridhurat.

Ai picërronte sytë, afronte pishtarin më tepër, por në valët e errëta të lumi nuk shikonte asgjë. U ngrit të dilte në gjysmën tjeter të pellgut. Gjunjët i ishin mpirë e sytë ju errën tek shikonte si reflektonej drita e pishtarit në sipërfaqen e ujit, që shkëlqente mbi shtresat e errëta të pellgut. Po edhe në gjysmën tjeter të pellgut u përsërit e njëjtë gjë. Bile këtu, Zyberi, s'i e lavdëroi usta Aqifin, kot shpresoi se do të dilnin peshqit. Nga inati filloj të shante e të mallëkonte... Po edhe pas kësaj s'pa asnjë peshk të lëvrinte atje në pellgun e tij.

Po afronte mesnata, kur Zyber Shkurti drejtoi trupin duke mbajtur ijet me dorë. Ju këput mesi nga të ndenjurit me trup të kërrusur, me pishtar në dorë e me sy të ngrirë nën majën e shigjetës.

Hodhi sytë nga rrjedha e lumi, ku s'pë gjë, veç dëgjoi zhurmën monotone të valëve. U bë gati të nisej për në shtëpi, kur përparrat tij dalloj një si hije që lëvizi. Ai u step dhe, duke shtrënguar shtizën e mprehtë, pyeti:

— Kush është aty?

Pas pak dëgjoi angullitjen e qenit. «Ç'paske

ikë nga shtëpia, o të përlaftë ujku», mallëkoi Zyberi qenin nëpër dhëmbë dhe vazhdoi rrugën monopatit të ngushtë, ku çdo gjë nxinte si nata.

«Iku dhe kjo ditë, tha me vete, nesër vijnë miqtë... Kroj dorën e majtë me majën e shigjetës. I hante dora Zyberit, ndaj tha me vete: «Shenjat janë të mira».

Dhe ecte nëpër natë...

*

* *

Kasëmi e njoju Zyberin, kur po ngjitej kodrës me pishtar në dorë, ndaj vendosi ta priste. Kishte rastin të bisedonte me Zyberin dhe shpresonte se ai do t'ja dinte për nder një gjë të tillë, se do ta shpëtonte nga «turpi» e nga ai Met Gjoka.

Kasëmi qëndronte ulur mbi një gur atje në qoshe të xhadesë, duke menduar të gjitha ato që do t'ja thoshte Zyberit që tashmë ishte fare pranë tij. Kasëmi po bëhej gati të ngrihej, ndaj drejtoi dorën e tij të merrte trastën e zbrazur e pishatarin, kur dëgjoi një angullitje mu në vesh, pastaj dhëmbët e qenit ju ngulën në qafë dhe gjaku i rroddhi gjoksit. Ngriti duart të kapte nga qafa qenin, por s'mundi, këmbët i shkanë dhe ra. Atëherë ai kapi shigjetën e tij.

U dëgjua një angullimë mbyturazi e nga turinjtë e skërmitur të qenit rridhnin vetëm jargë e pas saj edhe një ulurimë ankuese.

Kasëmi qe ngritur në këmbë duke prekur pla-

gën e hapur. Dora ju skuq nga gjaku. Zyberi, kur pa qenin të shtrirë, pyeti i nxehur:

— Ti e vrate?

— Më hëngri keq, Zyber. Shiko plagën — u ankua Kasëmi.

— Dhe e vrate qenin, ë?

Zyberi bëri një hap drejt tij.

Kasëmi deshte t'i largohej, por gjaku që i rridhite nga plaga e hapur e bënë Zyber Shkurtin të stepej.

— Do të ma paguash qenin si frëngu pulën.

— Kaq mundi e tha. Sytë s'ja ndante qenit.

— ...

Për çudi Kasëmi heshti, jo se ishte fajtor, por se plaga i dhembte shumë.

— Hajt të të vë pak duhan, more dreq, se po të rrjedh shumë gjak. Për besë çka me të ba. Ah, çfarë qeni! E kam rritë për merak. E mbylla në avlli, po se nga doli. Ka qenë shkruar sahati i tij. Kështu janë edhe njerëzit. Sa janë, sa thonë vdiq...

— dhe kështu bisedoi derisa mbi plagën e hapur Zyberi vuri gjithë duhanin e kutisë. — Duhani më shkoi, po plaga nuk rrjedh më, o Kasëm. Shko vrap në shpi e nesër mjekoje te doktori, se qeni është i pistë...

Kasëmi u nis rrugës ngadalë duke mbajtur kokën të mbështetur në supin e djathtë. I merreshin mendtë. Plaga i digjte nga duhani. Gjaku i rënë në duar e qafë kishtë filluar të thahej. Ai ndërronte hapat ngadalë duke shikuar se ku mund të ulej për të pushuar pak a mos takonte njeri rrugës.

Kur doli Zyberi me pishtar në dorë nga dera e avllisë, dëgjoi qenin e tij duke lehur. Metit filloi t'i rrihte zemra me forcë. Ai treste shikimin në errësirën sikur donte të gjente një fill drite e të shikonte çdo gjë deri atje ku nxinte ajo shtëpi. Herë pas here shikonte pishtarin që zhdukej prapa lisave, pastaj ja ngulte sytë shtëpisë. Ju kujtuan fjalët e Gjergjit:

«Ai ka nevojë për ndihmën tonë. Me atë duhet të punojmë. Është njeriu ynë, që mbart në ndërgjegjen e tij mbeturinat e së kaluarës. Zarifja mund të bëhet viktimë e koncepteve të të atit. Ne duhet ta ndihmojmë atë, edhe sikur të mos ishe ti, Met, ai që e dashuron».

Ai lëvizi me kujdes prozhmit me lisa e, tek ndërronte hapa, dëgjonte gjethet dhe degët tek thyheshin duke lëshuar krisma të thata. Nata nxinte. Yjet në qiell sa vinin e dukeshin më mirë ashtu të rralla, të zbeta. Pastaj ndaloi. «Unë po shkoj te shtëpia e tij. Ai iku... Mos tregohem burracak. Ajo shtëpi është me gra e fëmijë... Unë... Me Zyberin do punojë vetë shoku Gjergj. Unë duhet të shkoj për Zarifen, për dashurinë tonë....» Dhe vazhdoi të ecte ngadalë. Sa më shumë i afrohej asaj shtëpie, aq më shumë bëhej më e madhe heshtja. Në kopshtin me kumbulla dëgjohej fëshfërima e gjetheve të rëna që i shtynte era të strukeshin rrëzë mureve, gardheve, ferrave...

Errësirë kudo. Meti u afrohej mureve të shtëpisë duke ulur kokën në degët e kërrusura e tërë gjëmba të kumbullave dhe, kur s'dëgjoi gjë, filloi

t'i ngjitej trungut të një molle deri atje ku degët e zhveshura të pemës ishin të përkulura e duke-shin si telat në skeletin e një ombrelle. Ato degë të përkulura gati sa nuk takonin me majat e tyre në lëndinë, ku era tallej me gjethet e rëna. Qeni, si pushoi së lehuri brenda avllisë, u dëgjua fare papritmas ja atje nën këmbët e Metit. Filloi të lehte përsëri, pastaj mori rrugën duke ndjekur erën nga kishte kaluar i zoti pak kohë më parë.

Ai ngriti sytë të shikonte nëpër ato mure ku çdo gjë nxinte në heshtjen e mërzitshme të natës, ku minutat të duken të gjata, tepër të gjata, sidomos tani që Meti priste Zarifen.

As ai vetë s'ishte në gjendje të dinte sa kohë qëndroi duke pritur atje mbi degët e zhveshura të mollës. Nën këmbët e tij, atje ku majat e degëve të përkulura gati sa s'takoheshin me tokën, dëgjoi hapa. Dikush ecte atje. Ekte dikush, me hapa të drojtur, duke matur qetësinë e natës së errët. Ju kujtua Kasëm Çeti, Zyberi, ju kujtua dhe Haxha, dhëndri i ardhshëm i Zyberit. Ai do të vinte nesër i gjuevar...

— Sss-t...

Hapat u zhdukën në errësirë. Dyshimi ju shtua më tepër. Asgjë nuk shikonte.

— Sss-t — përsëriti.

— Met! — u dëgjua si fëshfërimë zëri i saj. Ishte Zarifja.

Ai u bë gati të hidhej nga pema në krahët e saj, por u pendua, se mund ta trembte atë duke rënë nga qielli i errët mes degëve të përkulura të mollës. Meti zbriti degët duke u kacavjerrë, pa i vënë veshin zhurmës që bënte tek zbriste. Ajo u

afrua te trungu i mollës duke zgjatur duart lart në errësirë, sikur do të merrte mollë të pjekura nga ajo pemë.

Dhe duart e tyre u bashkuan në errësirë. Të dyve u bëhej sikur ishin në ëndërr në krahët e një ri-tjetrit.

Tek dëgjonin të rrahuat e zemrave nga afër njëri-tjetrit, ata bëheshin më të fortë dhe në ato çaste nuk ndjenin as frikë, as drojtje.

— Met!

— Zarife!

— Nesër vijnë.

— Kush?

— Ata.

— Le të vijnë.

— Do të më fejojë babai.

— Jo.

— Do të vij me ty — dhe i mbështeti kokën mbi gjoks. Do të vij me ty, Met.

— Jo, Zarife.

Ajo largoi trupin e trembur.

— Zarife.

— ...

— Ty s'të fejojnë dot, Zarife.

— ...

— A ke frikë, Zarife?

— Kam.

— Mos ki frikë pra. Vepro me guxim. Kështu më tha sekretari i partisë, shoku Gjergji. Dashurinë tonë e mbron Partia, Zarife.

— A u paske treguar, Met?

— Po.

— Dhe si të thanë.

- «Të veproni me guxim.»
- Ja, unë po vij me ty, nuk është guxim ky?
- Neve na duhet tjetër guxim, Zarife.
- Met, nuk po të kuptoj.
- Dëgjo, Zarife. Ti duhet të veprosh me guxim. Ata le të vijnë. Ti t'ua thuash në sy. S'kanë ç'të bëjnë. Me të e me mua është Partia. Kur ne bëjmë atë që na thotë Partia, pse ta bëjmë natën? Martesën tonë ne do ta bëjmë ditën me diell.
- Zarifja u rras më tepër në gjoksin e tij. Met ti shikoi qiellin, pastaj uli kokën te koka e saj.
- Unë kam frikë nga baba, nga...
- Ata s'kanë ç'të bëjnë, në qoftë se do të jesh e guximshme.
- Në shtëpi do shkosh pastaj. Ç'e shikon qieillin?
- Jo, në punë.
- Kaq vonë? Është e vështirë rruga. Është natë. Rri me mua këtu...
- Unë erdha për ty, por punën s'e kam harruar.
- Është larg, Met. Shokët s'të thonë gjë?
- Do shkoj më një shokun tim shofer. Më pret me maqinë atje përtej kodrës.
- Met...
- Folë, Zarife.
- Ku do të gjejmë ne rast më të mirë se sonte. Të ikim me maqinë ku të duash ti, veç më lërë. Babai nga frika e kooperativës do të më fejojë mua. I kanë premtue para ata. S'do të pyesin për fjalët e mia. «Një dorë pare të mirë të çon kandar edhe po hyre në kooperativë», kështu i tha daja babës.
- Zarife, edhe për Zyberin ti duhet të që-

ndrosh. Kështu më tha shoku Gjergj. Ai duhet ndihmuar. Si çdo plak, ai ka mbeturinat e tij, edhe ne kemi, por më pak. Shoku Gjergj më tha kështu: «Të futemi në kooperativë, është rruga që na tregon Partia. Kush nuk e ndjek këtë rrugë dhe është kundër kolektivizimit, ai si rrjedhim është kundra dashurisë sonë.» Ti po e shikon vetë me sy. Që kur Zyberi rri pa punë, ne s'jemi takuar asnjëherë.

— Baba u zu dje me usta Aqifin.

— Pse?

— Usta Aqifi i kishte thënë se andej, ku janë ngritur kooperativat, jo vetëm që lulëzon jeta, por edhe martesat të rinjtë i bëjnë vetë duke zgjedhur njëri-tjetrin. Baba ishte zemëruar vetëm se i kish-te dëgjuar këto fjalë të fliteshin në oborrin e shtëpisë së tij. Po sikur vërtet ta marrë vesh një gjë të tillë se në fshatin tonë e para bija e tij po...

— Hë, thuaje — e nxiti Meti.

— ... po martohet — tha ajo dhe qeshi lehtë.

— A mos kujton ti se në fshatin tonë vetëm ne të dy e duam njëri-tjetrin? Jo. Ka plot të rinj. Ka pasë edhe përpëra dhe do të ketë. Do të shikosh sa martesa do të bëhen. Ne do të çajmë me guxim të parët në këtë rrugë, që i vë zjarrin një zakoni të tmerrshëm.

— Ndoshta kjo do ta helmojë më tepër babën. Kjo...

— Me Zyberin do të punojë vetë shoku Gjergj dhe Selimi.

Zarifes, duke mbështetur kokën aë gjoksin e tij, një vegim i bardhë si rreze drite ju faneps midis errësirës së natës dhe nga gëzimi gjoksi i fryrë filloj t'i ngrihej me forcë. Treste shikimin

diku larg, mendohej... Në kodër, përtej shtëpisë, u duk një dritë tek afrohej ngadalë nëpër pyllin me lisa të gjatë.

— Erdhi baba nga lumi — tha Zarifja e trembur.

Papritur ajo u shkëput nga krahët e tij.

— Met...

— Zarife... — Po zëri i tij u përzie me fësh-fërimën e gjetheve: Dhe s'e dëgjoi më erën që frynte e gjethet e thara i dukeshin sikur qëndronin në vend palëvizur... Ajo ikte me vrap nëpër errësirë..:

Ndjeu të ftohtë në trup dhe u çudit pse pikërisht tanë ai mërdhihte?

Edhe pak dhe do të zbardhë dita e re....

* * *

Dhoma e miqve qe shtruar e rregulluar si rrallëherë, po Zyberi nuk harroi t'i hidhët një shikim nga praku i derës dhe njëkohësisht t'i thoshtë së shoqes:

— Na e vrou qenin ai i mallëkuar. Shtëpia pa qen është njëlloj sikur të mos kemi fare dyer për t'i mbyllur. Hyn e del kush të dojë e kur të dojë. Po do të ma paguajë. I thashë mbrëmë atij, Kasëm Çetit. Nuk pata kohë, pa do t'i kisha shkuar që sot te shtëpia.

— Atë e kishte çuar në spital natën Meti i Sali Gjokës, o burrë. Ti...

— Po do të kthehet...:

— ...

— Ata ishin zanë një ditë, prapë u pajtuan?

— Epo tē rintjtë kështu e kanë — tha Rabija e gëzuar që i shoqi nuk e dinte akoma pse ishin zë-në ata tē dy. Pas pak i tha tē dilte që tē priste miqtë.

— Ku janë, moj?

— U futën në rrugën tonë.

— Na bjerë ca prush e ndize shpejt zgarrin. I ke mbushur ibrikët me ujë? Mos e le vajzen tē lëvizë jashtë dere.

Rabija shikonte miqtë nga një frëngji e errët. Ishin tē shtatë ashtu siç kishin qenë edhe natën tjetër. I pari ecte Haxha hijerëndë. Zyberi i priti miqtë dhe u priu përpara për në dhomë ku ishin shtruar qilimat dhe sixhadet, zjarri i ndezur, tabakatë me filxhane me kafe, sheqer, paqeta stivë.

Miqtë u ulën në ato vendet që kishin qenë natën tjetër. Ata s'i harronin, se, edhe kur ecnin rrugës në kolonë, njëri pas tjetrit, e dinin vendin e tyre. Një skuadër e çuditshme me Haxhën në krye.

Ishin tē gëzuar, ndaj fytyrat u qeshnin. Zyberit ju dukën sytë e Haxhës më tē groposur, më tē mirë, më tē dashur. Por...

Zyberi u tregoi për qenin, që ja kishin vrarë. Miqtë e ngriten në qiell atë qen. Zyberi e lavdëronte gjithnjë dhe në fund nuk harroi tē thoshte:

— Do tē ma paguajë i mallëkuari.

Miqtë e përkrahën mendimin e Zyberit duke ndërruar tonin e lavdërimeve në atë tē hakmarrjes me pagesë...

— O Zyber Shkurti! — u dëgjua zëri në derë.

Zyberi ngriti sytë nga dritarja me përtesë. — Kush dreqin thërret? Ç'po na prish punë. — Pastaj ju drejtua miqve:

— Keni njeri mbrapa, ju o miq?

— Jo — u përgjegjën njëzëri.

Në korridor u dëgjuan hapat, pastaj dera u hap. Një erë e fortë fryu atë çast duke u përplasur dyerive dhe korridorit. Oxhaku ktheu nga gryka e tij një shtëllungë të madhe tymi sikur s'e gjelltiste dot. Zyberi shtyu urët, ndërsa miqtë qenë ngritur në këmbë duke picërruar sytë nga tymi që mbushi dhomën.

«Po ky ç'do këtu?! Ftuar s'e ka njeri... Unë s'i kam shkuar në shtëpi ta thérres. Po ky ç'do në këtë natë i paftuar?!»

Këto pyetje e mundonin Zyberin, ndaj dhe fytyra i nxinte si bloza e oxhakut.

Edhe Selimi nuk i kishte ardhur kohët e fundit në shtëpi Zyberit dhe ky u shmangej takimeve me të. Po Selimi, si sekretar organizate që ishte e kishte thirrur disa herë dhe kishte biseduar derisa një ditë i kishte thënë: «Ty Zyber Shkurti të është mësuar goja për çdo gjë të thuash «Jo, jo». Po nuk i shikon shokët. Nuk kanë fëmi-jë këta, vetëm ti...». Zyberi nuk i kishte harruar këto fjalë. «Të ketë ardhë për kooperativë, mendoi ai. Jo. S'është e mundur të vijë vetëm një njeri. Do t'i vijnë të tjerët pas ndoshta.»

Miqtë kujtuan se e kishte ftuar Selimin, por shpejt ata kuptuan çdo gjë nga fytyra e ngrysur e Zyberit.

Selimi kishte zënë një vend aty përballë oxhakut. Qe ulur në një post dhe shikonte herë Ha-

xhën e herë Zyberin, pastaj bisedonte me miqtë. Më tepër i pyeste ai vetë.

Rabija linte tepsitë e mbushura me mish e me byrek dhe afrohej pas derës të dëgjonte se a flisnin, apo jo. Kishte të drejtë. Qe mësuar të dëgjonte zëra, të qeshura që nga dhoma tjetër. Ndërsa tani për çudi muhabeti qe ftohur. Vetëm të klliturat u dëgjonte.

Erdhi koha për të pirë kafen e fejesës.

Zyberit i dridhej dora. Ai s'e kishte menduar se do t'i vinte Selimi. Me atë kafe do fejonte të bijën, Zarifen, por nga goja s'i nxirrte dot ato dy fjalë: «Për hajër».

Në dhomë erdhi edhe Rabija që të ishte aty në atë rit solemn. Në dhomë ra heshtja. Dëgjohej vetëm kërcitja e druve që digjeshin në zjarr duke lëshuar një flakë të kuqe.

Ishte e dyta herë që e trempte dera e tij Zyber Shkurtin: së pari kur erdhi Selimi dhe tani... që ishin mbledhur të gjithë e s'kishte kush të vinte tjetër. Dera u hap dhe të gjithë panë të habitur atje Zarifen. Zyberit i shpëtoi xhezvja nga dora, nga e cila u derdh kafja në vatër. Shpuza lëshonte atë zhuuu-në e saj.

Në dhomë kumboi zëri i vajzës:

— Babë! — ju drejtua ajo Zyberit. Në këtë shtëpi janë pritur e përcjellur njerëzit ashtu si e kanë merituar. — Ajo qe skuqur në fytyrë e, tek nxirrte fjalët nga goja, sytë i shkrepëtinin dhe zëri i dridhej. — Sa për mue mos jep as fjalë, as kafe.

Miqtë shikuan njëri-tjetrin në sy. Haxha uli kokën, ndërsa Zyberi me sy të zgurdulluar mbësh-teti duart që të ngrihej në këmbë, por supi i tij

ndeshi në dorën e Selimit dhe përsëri u ul atje ku ishte.

— Përjashta, bushtër! — shau ai.

Rabija e kapi të bijën për krahu që ta nxirrte nga dhoma, por ajo foli. Zëri i saj tingëlloi çuditshëm:

— Jo, nanë. Edhe pse jam femër, kam të drejtë të rri me burra e sidomos tanë që luhet me fatin tim. Të ma mohoni mua atë që Partia na e fali, atë që Partia e mbron....

Zyberi dëgjonte me sy të zgurdulluar dhe shante e shfrynte me hundë nga inati.

— Mos e pengoni çekën, ajo ka të drejtën e saj. Këtu ajo thotë atë që ndjen dhe kjo nuk është turp as për ty, Zyber, e as për çekën, as për miqtë — tha Selimi dhe u kthye nga Haxha:

— Edhe ti, o Haxhë, duhet ta kuptosh mirë këtë. Ty askush nuk të shan, as të thotë një fjalë të keqe, por Zarifja, si dhe ti, ka të drejtë të thotë fjalën e saj. Mjaft më me të vjetërën: Deri këtu dhe ne i thamë: «Ndal», si armikut edhe sot zakonit të keq të së kaluarës:

— Ime bijë merr atë që i them unë, o Selim — foli Zyberi: — Të paktën kështu e kam ditë derisa erdhe ti:

Selimi i hodhi sytë Zyberit, pastaj Zarifes:

— Më mirë le të flasë Zarifja vetë: Folë, Zarife! — kumboi fjala e sekretarit:

— Unë, derisa erdhët ju, — vazhdoi ajo — vërtet që nuk fola. Dhe gjithë këto ditë kam menduar që të flas dhe të them dhe unë fjalën time. E kush më pyeti mua? Dhe këto që them janë ato që ndjej në zemër. Unë asnjëherë s'kam dëshiruar

dhe as do të dëshiroj që të martohem me një njeri krejt të panjohur për mua. — Zarifja ishte gati të shfrente mbi atë heshtjen e atyre burrave dhe çuditej me atë forcën e saj që deri atë natë s'e kishte njojur.

Rabija e shikoi me dhembje të bijën, ndërsa Zyberi qëndronte me sy të ngrirë mbi kafen e derdhur në vatër. Atë natë u thyen e u derdhën shumë mendime, dëshira.

E P I L O G

Lumi ushtonte në rrjedhën e tij i qetë, i kalltër. Malet i kishte mbuluar mjegulla. Në Rrasë erdhë ekipi për ngritjen e kooperativës. Sado që borra s'kishte filluar, në Rrasë kishte rënë një ortek, orteku i revolucionit, orteku i fshatarëve të Rrasës..., ortek i madh e i paparë deri atëhere. Ai zbardhi kodra e lugina deri atje në malet e larta ku retë dukeshin sikur pushonin në tokën tonë.

Mëngjezi i parë. Kërciti një pushkë. Hyri një — thanë — kërcitën dy, tri, pesë, njëmbëdhjetë, trembëdhjetë... radhas, njëra pas tjetrës. Pastaj një pauzë. Po pushkët kërcitën edhe atë mbasidite, natën, të nesërmën, pas dhjetë ditësh. Qëlloi pastaj një pushkë e madhe, e krisma e saj jehoi si gjëmim. E dëgjoi atdheu mbarë se në Rrasë u ngrit kooperativa.

* * *

Fshati ka festë Fshati ka dasmë. Dasma e parë socialiste. Një maqinë «Zis» kishte marrë pamje të çuditshme:

Ajo ecte ngadalë. Dukej sikur mbi të ishte mbledhur gjithë gjëzimi i njerëzve. Atje u mblo-dhën të gjithë, burra, gra, punëtorë, kooperativistë e maqina ecën duke gulçuar nën peshën e rëndë. Sondisti Simon ja thotë me zë të lartë dhe kënga fluturon anembanë fshatit, kënga e dashur e tij:

*...Shndriti dielli mbi malësi,
rrofsh sa malet, moj Parti!..*

Maqina ecte ngadalë duke u lëkundur nëpër gropat e rrugës. Në qendër të kooperativës që mbledhur gjithë fshati...

Fshati Rrasë ka dasmë, dasmën e parë sociale që bënte kooperativa bujqësore «Pruga e Partisë».

Gjergji e Selimi atje midis njerëzve i buzëqeshin njëri-tjetrit. Zyberi është i menduar. Xha Saliu nuk ua ndan sytë atyre, pastaj u shkon pranë e diçka u thotë dhe të tre qeshën me të madhe.

Kënga ka pushtuar fshatin, ajo fluturon gjithandej mbi male, kodra e në grykat e ngushta ku rrjedh i qetë lumi ujë-kaltër.

Çifti i ri shikon përpara.

TREGUESI I LËNDËS

	Faqe
«Po e çoj kangën te shpia»	3
Unë jam rritur, shoku komandant	10
Holta.	16
Kur gjuhej guri në shenjë	25
Një këngë që do këndoja unë	33
Një palë opinga	45
Litari në valë	54
Kur koloviteshin troftat nën pishtarë	63